



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Politika dhe Qeverisja në Evropë”**

i

Institucionit të arsimit të lartë “Universiteti i Tiranës”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As Gert Guri


2. PhD Elvin Gjevori

Nëntor/2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë”
ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Legjislacion dhe Politika të BE
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 1183, datë 03.12.2009
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.297, datë 20.07.2012
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip dhe anglisht ¹ (duke filluar nga 2022)
13 [*]	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	7
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	8/1
18	Numri i studentëve:	2019 -2020: 11 studentë 2020 – 2021: 5 studentë 2021 – 2022: 6 studentë
19	Komente / të tjera:	

¹ Sipas UMAS Nr.110, datë 04.03.2022, ky program studimi ofrohet edhe në gjuhën angleze.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Instituti i Studimeve Evropiane (ISE) është njësi kryesore, **ndërfakultetore** e Universitetit të Tiranës (UT), krijuare me VKM nr. 588, dt. 02.11.2000 me emrin “*Qendra për Studime Evropiane*”, dhe më vonë me VKM nr. 1182, dt.03.12.2009 u shndërrua në Institutin e Studimeve Evropiane (ISE).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (Statuti i Universitetit) rezulton se ISE është e përbërë nga dy departamente si njësi bazë: Departamenti “Legjislacion dhe politika të BE-së”; dhe Departamenti “Diplomaci dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare të BE-së”. Këto departamente ofrojnë programe të ciklit të dytë Master i Shkencave dhe programe të ciklit të tretë të studimeve.

Programi i Studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë” është hapur më VKM nr. 1182, dt.03.12.2009, ai ofrohet me kohë të plotë, në gjuhën shqipe, 120 ECTS dhe kohë zgjatje 2 vite akademike. Duke filluar nga 2022, programi do të ofrohet edhe në gjuhën angleze, sipas UMAS Nr.110, datë 04.03.2022.

Ky është akreditimi i pare për këtë program studimi në valën e akreditimeve për herë të pare të një sërë programesh studimi të Universitetit të Tiranës. Si i tillë ky përbën një hap tepër pozitiv përpara për rritjen e cilësisë së programit të studimit dhe konsolidimin e kulturës së cilësisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

Vlen të theksojmë se ISE është fitues i projektit *Jean Monnet Chair (OwnEU)* duke qenë i pari institucion i arsimit të lartë që ka fituar një project të tillë nga Komisioni Evropian. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni si edhe nga takimet e realizuara në vend, rezulton që në kuadër të këtij projekti ISE ka zhvilluar dy kurse gjatë semestrit të dytë të vitit akademik 2021-2022, përkatësisht; *EU Enlargement and the Western Balkans* dhe *EU Institutions and Policy Making*.

Po aq e rëndësishme përsa i përket ndërkombëtarizimit, një pjesë e mirë e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi ka kryer të paktën një cikël studimi jashtë vendit dhe gjithashtu vazhdojnë kualifikimet për t’u rritur profesionalisht. Po aq e rëndësishme përsa i përket ndërkombëtarizimit, që nga 2022 ky program studimi ofrohet edhe në gjuhën angleze.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë” i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe sipas drejtuesve të ISE është konceptuar në përputhje me standartet dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

Nga takimi me studentë të këtij programi studimi doli në pak që ata mbështën shumë nga stafi akademik dukë përfshirë studentët në punët e tyre kërkimore, organizimin e konferencave, organizimin e eventeve dhe përditësimin me të rehat më të fundit në fushën e shkencave politike si edhe atë të integritimit evropian.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM:

Raporti i vlerësimit të jashtëm është hartuar nga GVJ, në përputhje me procedurën e vlerësimit të ndjekur nga ASCAL. GVJ është trajnuar paraprakisht nga ASCAL, ku janë njohur me parimet kryesore të një procesi vlerësimi. Raport i vlerësimit të jashtëm përmban informacionet e mbledhura nga shqyrtimi i dokumentacionit që Institucioni ka vënë në dispozicion dhe vizitës së realizuar për këtë proces. Vlerësimet për çdo standard dhe fushë synojnë të paraqesë sa më reale, figurën në të cilën performon institucioni në ofrimin e këtij programi studimi.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht. (ascal.al, standardet)

Procesi është koordinuar nga ASCAL në përputhje me afatet e përcaktuara me të cilat grupi i vlerësimit të jashtëm është njohur që në fillim të angazhimit të tij. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga PhD. Elvin Gjevori ekspert vendas dhe drejtues i GVJ dhe Prof. As. Gert Guri ekspert i huaj. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Muhamed Prezja, përfaqësues i ASCAL.

Gjatë gjithë fazës së vlerësimit, GVJ ka shqyrtuar dhe analizuar mjaft dokumente dhe informacione të përgatitura nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm për këtë proces vlerësimi. Dokumentacioni i vënë në dispozicion të procesit ka ndihmuar në hartimin e Raportit të jashtëm. Ky dokumentacion ka ndihmuar dhe orientuar GVJ për hartimin e pyetje, të cilat u realizuan gjatë vizitës në vend. Gjithashtu një informacion i plotë dhe i detajuar është marrë gjatë vizitës Institutin e Studimeve Europiane të zhvillua në datat **7 dhe 8 Korrik 2022** sipas një agjende gjithëpërfshirëse të hartuar nga grupi i vlerësimit të jashtëm me asistencën e ASCAL.

Grupi i vlerësimit në këtë raport është kujdesur të pasqyrojnë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep një vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga ISE në ofrimin e një programi të mirë Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë”, gjithashtu jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat mendojmë se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur ambicien e tyre, të krahasueshme me nivelet ndërkombëtare për gjeneratën e ardhshme të politologëve të rinj.

Më datë 10.10.2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr.52/125, datë 10.10.2022 dërgohet në institucion Draft-Raporti i Vlerësimit të Jashtëm. Më datë 07.11.2022 institucioni dërgon me shkresë zyrtare Nr. 2730/9 Prot., datë 07.11.2022, me lëndë “Përcillen komentet për RVJ të dy programeve të ISE”, komentet në lidhje me Draft-Raportin.



Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, pasi u njoh me komentet e IAL mbi Draft-Raportit, shprehet si vijon:

Për komentin e parë: GVJ shprehet se nuk e merr në konsideratë pasi Raporti në përmbledhjen e tij në faqen 3, paragrafi 5 i ka theksuar projektet që ka fituar ISE në kuadrin e thirrjes Jean Monnet.

Për komentin e dytë lidhur me standartin I.6 Kriteri 5 GVJ shprehet se e nuk e merr në konsideratë dhe integruar në raportin përfundimtar.

Për komentin e tretë lidhur me Standardin III.1, Kriteri 3: GVJ shprehet se e ka marrë në konsideratë pasi raporti pasqyron gjendjen në momentin e akreditimit të programit.



Për komentin e katërt lidhur me standartin 1.4 Standardi III.4, Kriteri 7: GVJ shprehet se nuk mer në konsideratë komentin e IAL. Raporti e ka theksuar në standartet e tjera si për shembull Standarti III.1, Kriteri 3, faqe 30, si edhe në disa kriteret e tjera pasjen e pyetësorëve të studentëve si metoda të mësimdhënies.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në
“Politika dhe Qeverisja në Evropë”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT
MASTER I SHKENCAVE**

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve”, në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ofron program studimi “Master i shkencave”/“Master i arteve” që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Ky program studimi është hartuar duke marrë parasysh nevojat e tregut të punës, traditën e IAL-së dhe ecurinë e proceseve integruese të vendit, dhe jo vetëm që nuk bie ndesh me interesat dhe vlerat/interesat kombëtare por i përçon ato tek brezi i ri. Programi i studimit Master i Shkencave “Politika dhe Qeverisja në Evropë” është në përputhje me interesat dhe synimet strategjike të zhvillimit politik-ekonomik të vendit sidomos pas hapjes zyrtare të negociatave për anëtarësim në BE. Ky program studimi është në linjë me politikën kombëtare të avancimit të procesit të integritimit evropian dhe bashkëpunimit rajonal si dhe të qeverisjes së mirë.</p> <p><i>(E. 3. Strategjia e Zhvillimit të UT-së, E. 5 Strategjia e ISE)</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Programi i studimit është në përputhje me zhvillimet politike jo vetëm të vendit, por të rajonit në përgjithësi, pasi një numër i konsiderueshëm lëndësh trajton proceset e demokratizimit dhe integritimit evropian me tema specifike të sistemit politik, partive politike dhe sistemeve elektorale, gjeopolitikës dhe sigurisë së rajonit, politikave rajonale dhe sociale si dhe menaxhimin e projekteve etj. Për më tepër, nëpërmjet ndërkombëtarizimit, ky program ka sjellë në institucion ‘know how’ të ri i cili ka potencialin për të përmirësuar vlerat akademike ekzistuese në institucion.</p> <p><i>(E.5 Plani i Zhvillimit të ISE).</i></p>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e IAL-së, për formimin akademik të studentëve në fushën e studimeve shoqërore-politike, me ndikim në rajon e më gjerë, duke ju ofruar një edukim cilësor në partneritet me institucione ndërkombëtare. Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion, ky program studimi është në përputhje të</p>

	<p>plotë me sa më sipër dhe ofron një shembull pozitiv se si tradita akademike dhe bashkëpunimi ndërkombëtar mund të ndërthuren në një program studimi.</p> <p>(E. 2 Statuti UT)</p>			
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>Ky program studimi pajis studentët me aftësi të mira teorike dhe praktike, i zhvillon njohuritë e gjuhës angleze dhe ofrohet nga një trupë akademike e kualifikuar, ku një pjesë e konsiderueshme e stafit akademik përfunduar studimet në një vend të BE. Programi i studimit është në përputhje me zhvillimet strategjike jo vetëm kombëtare por edhe ato rajonale pasi ofron ekspertizë specifike në lidhje me zhvillimet politike dhe proceset integruese të rajonit dhe vendit. Me hapjen e negociatave, të cilat do të jenë të gjata dhe me nevojë për ekspertizë teknike, të diplomuarit e këtij programi, mund të gjejnë një treg të favorshëm pune.</p> <p>(E. 11 Plani mësimor, sylabuset e lëndëve)</p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” krijon baza të qëndrueshme njohurish për studime të thelluara të ciklit të tretë, duke përfshirë aftësimin e thelluar profesional e shkencor</p>	<p>Ky program studimi i ofron studentëve një trajnim gjithëpërfshirës të metodave, teknikave dhe instrumentave të kërkimit shkencor në diplomaci e marrëdhënie ndërkombëtare duke mundësuar përvetësimin e kompetencave dhe aftësive shkencore për vazhdimësinë e studimeve të thelluara në ciklin e tretë të studimeve (ISE ofron vetëm programe të ciklit të dytë dhe të tretë pasi ka ekspertizë në metodat e kërkimit). Programi gjithashtu garanton formimin dhe aftësimin e studentit për kërkimin shkencor pasi në përbërje të kurrikulës ka lëndë specifike për metodat e kërkimit dhe një pjesë e mirë e punës së studentit fokusohet tek tema e masterit e cila udhëhiqet nga një ekspert i fushës.</p> <p>(E. Plani mësimor, sylabuset e lëndëve).</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi I.2

Programi i studimit MSH/MA është në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programi i studimit	Bazuar në Statutin e UT si dhe Planin Strategjik (2018 – 2023),

<p>hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>programi i studimit është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me dhe në zbatim të strategjisë për zhvillimin institucional të UT-së.</p> <p>Një nga objektivat e institucionit (UT) është ruajtja dhe avancimi i profilit të tij kryesor, si p.sh., në studimet evropiane dhe integrimi, e cila është edhe një nga prioritetet në fushat dhe drejtimet kryesore të kërkimit shkencor. Ky program studimi është në përputhje me këtë objektiv dhe e çon përpara atë.</p> <p><i>(E.3 - Plani Strategjik i Zhvillimit Institucional 2018-2023 të UT-së).</i></p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet dhe zbatohet në përputhje me statutin dhe rregulloren e përgjithshme të IAL-së si edhe atë të ISE. Bazuar në planin e zhvillimit të ISE, programi i studimit synon të formojë kërkues të rinj të cilët janë të orientuar drejt aktiviteteve akademike dhe kërkimore. Programi është reflektim dhe mishërim i prioritetëve të shkruara në statutin e UT dhe rregulloren e ISE.</p> <p><i>(E. 2 Statuti i UT)</i></p>
<p>Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë” është i përshtatshëm për nivelin e studimeve të ciklit të dytë si nga forma, përmbajtja ashtu dhe shtrirja kohore. Ky program studimi ka një ngarkesë prej 120 ECTS të shtrirë në një kohëzgjatje studimi prej 2 vitesh (4 semestra) dhe emërtimi i tij është i përshtatshëm për disiplinën e shkencave politike dhe studimeve evropiane me theks në proceset demokratizuese dhe integruese. Ky program është në përputhje dhe vazhdimësi me një nga fushat e drejtimit akademik të institucionit, atë të shkencave politike dhe studimeve evropiane.</p> <p><i>(E. 2 Statuti i UT)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me prioritetet kombëtare e ato evropiane për zhvillim e kurrikulave në disiplinën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ndërkombëtarizimin dhe përvetësimin e praktikave të mira evropiane si dhe të kurrikulës në shkenca politike dhe studime evropiane në realitetin akademik kombëtar. Duke qenë që Shqipëria ka hyrë në një stad të ri, shumë më të avancuar të integritimit evropian, ky program studimi është një element i rëndësishëm për prodhimin e profesionistëve që do të jenë shumë të nevojshëm për vitet në vijim.</p>

	Gjithashtu bazuar në planin e zhvillimit të ISE, programi i studimit synon ofrimin e edukimit me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë të denjë dhe të përgjegjshëm në një shoqëri globale i cili është një tjetër element i rëndësishëm dhe inovator i programit të studimit.			
	<i>(E.5 Plani i Zhvillimit të ISE)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon të plotësojë nevojat e tregut të punës dhe ofrohet në përputhje me kërkesat e tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë njohuritë e thelluara shkencore, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.	Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara objektivat formuese të cilat synojnë: a) të pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në lidhje diplomacinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në BE, si edhe të gërshetojë formimin e tyre teorik me atë praktik; b) të inkurajojë dhe të aftësojë studentët, të formojnë pikpamjet e tyre dhe të gjenerojnë analiza për çështjet e politologjisë dhe procesit të integritimit evropian; c) t’i japë njohuri mbi Bashkimin Evropian, politikat, institucionet evropiane, diplomacinë dhe marrëdhëniet në BE, etj; d) të pajisë të diplomuarit me njohuri specifike shkencore dhe metodologjike në lidhje me politikë-bërjen në evropë, aftësimin e tyre në kryerjen e punë së pavarur prej tyre etj. Në tërësi këto objektiva janë të arsyeshme, të argumentuara, të bëshme e në linjë me praktikatat ndërkombëtare. <i>(E.7. Rregullore e Programit të Studimit).</i>
Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programin e studimit që ofron përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e	ISE ka dorëzuar për këtë program studimi një dokument në të cilin ka paraqitur prioritetet e këtij programi studimi dhe si ato mund të lidhen me tregun e punës. Duhet thënë që dokumenti nuk është një analizë e mirëfilltë e tregut të punës dhe kështu nevojitet të përmirësohet në të ardhmen e afërt. Tani që vendi ynë ka hapur negociatat për anëtarësimin në BE do të ishte edhe më e nevojshëm hartimi i këtij dokumenti për të kuptuar qartë prioritetet e tregut të punës por edhe për përmirësimin e mëtejshëm të kurikulës. Gjithashtu dokumenti duhet të përmbajë edhe mundësitë e punësimit të studentëve të cilët do të diplomohen në

<p>pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>këtë program.) <i>Për sa më sipër GVJ i sugjeron departamentit të hartojë analizë më të plotë të tregut punës për programin e studimit MSh në "Politika dhe qeverisja në evropë".</i> <i>(E. 15 Analizë e tregut të punës)</i></p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësi, shkathhtësi e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar mbi programin e studimit, rezulton se ai synon të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të aftë në shkencat politike dhe për të njohur me kompetencë mënyrën e zhvillimit të politikave në vendet e Bashkimit Europian, duke i shërbyer kërkesave të tregut për specializime në aspektet më të rëndësishme politikëbërëse, por edhe sfidave të integritimit evropian. Bazuar në sa më sipër GVJ vlerëson se programi i studimit ofron dije të cilat mundësojnë integrimin e të diplomuarve në tregun vendor të punës. Ky vlerësim forcohet edhe më tej duke u bazuar në faktin që punësimi i të diplomuarve në këtë program studimi është shumë i lartë siç u tha edhe nga vetë studentët dhe alumni në takimet me to.</p> <p><i>(E.7. Rregullore e Programit të Studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përfaqësohet me programe studimi të ngjashme të ofruara nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit - në strukturë, organizim dhe përmbajtje – është i krahasueshëm me programe të ngjashme të ofruara në IAL në shtete të BE. Për më tepër programi i studimit ofrohet me ECTS dhe në përputhje me kërkesat dhe pritshmëritë e zonës evropiane të arsimit të lartë. E vetmja gjë që mund të përmirësohet në këtë kuadër është përditësimi i literaturës pas kjo është një fushë që ndryshon shpejt. Gjithësesi kjo është një vështirësi për të gjitha programet e ngjashme të studimit në Shqipëri pasi përkthimi e marrja e të drejtave të autorit për tekstet më të fundit është proces i gjatë dhe i kushtueshëm.</p> <p><i>(E.7. Rregullore e Programit të Studimit. Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit hartohet në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara, mbështetet në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>	<p>Programi i studimit nuk ka lidhje me profesionet e rregulluara dhe ndjek udhëzimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë të cilat, në shumicën e rasteve, janë të inkuorpuara në legjislacionin vendas. Duke qenë që GVJ kishte lektor nga një IAL vend anëtar i BE, GVJ nuk vuri re ndonjë element në kundërshtim me objektivat e BE për arsimin e lartë apo praktikën e mira të vendeve evropiane.</p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit "Master i shkencave"/"Master i arteve" përfshin aftësimin profesional në praktikën profesionale të përputhura me</p>	<p>Në programin e studimit parashikohet praktikë profesionale e cila përbën 10% (12 ECTS) të programit të studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këtë kuadër, ISE mbështet</p>

<p>qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.</p>	<p>studentët duke ofruar një listë institucionesh partnere për realizimin e praktikave. Nga takimi me studentët rezultoi se praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte të ndryshme, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim. Praktika zhvillohet në bashkëpunim me subjekte publike apo (më rrallë) private në funksion të objektivave të këtij programi dhe nën drejtimin e personelit akademik të caktuar për këtë qëllim. Në fund të praktikës studentët platësojnë një dokument më të gjitha veprimtaritë që ata kanë realizuar dhe marrin vlerësimin përkatës.</p> <p><i>(E.7 Rregullore e Programit të Studimit, Takimi me studentët)</i></p>			
<p>Kriteri 7. Në programin e studimit “Master i shkencave”/ “Master i arteve”, duhet të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj, rritjen e mobilitetit në kuadër të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin e institucionit.</p>	<p>Programi ofrohet në gjuhën shqipe, por sipas UMAS Nr.110, datë 04.03.2022, duke filluar nga viti akademik 2022 -2023 ky program studimi do të ofrohet edhe në gjuhën angleze. Ofrimi i programit në gjuhën angleze i krijon mundësinë studentëve që e ndjekin atë të punësohen me lehtësi në institucione vendase, por edhe të huaja të cilat operojnë në fushën e shkencave politike, por edhe të atyre që janë të lidhura ngushtësisht me integrimin evropian. Në këtë kuadër, sidomos në kuadër të projektit Jean Monnet Chair, ISE ofron module në gjuhën angleze të cilat kanë rritur gamën e diskutimeve, leximeve dhe leksioneve të mbajtura në gjuhën angleze.</p> <p><i>(E.7. Rregullore e Programit të Studimit, Plani mësimor, Sullabuset).</i></p>			
<p>Kriteri 8. Për programin studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni përgatit, ruan dhe arkivon të gjithë dokumentacionin dhe aktivitetin e zhvilluar edhe në gjuhën angleze</p>	<p>Dokumentacioni për këtë program studimi është në gjuhën shqipe ashtu ashtu sikurse ofrohet. Dokumentacioni që ka lidhje me ndërkombëtarizimin – aplikime, leksione të përbashkëta, etj. – është në gjuhën angleze.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi I.4</p>	
<p>Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>IAL ka një përvojë të gjatë në fushën e studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, me përfshirjen e stafit akademik, studiuesve dhe personaliteteve të kualifikuara dhe me përvojë. Instituti i Studimeve Evropiane të UT është ndoshta njësi më e</p>

	<p>përshtatshme në UT për të ofruar këtë program studimi. Staf i akademik i angazhuar në këtë program studimi është i përshtatshëm dhe i kualifikuar. Aktualisht ky program studimi ofrohet nga departamenti Legjislaçion dhe Politika të BE, por në mësimdhënie është i angazhuar i gjithë stafi i Institutit si dhe staf me kohë të plotë në njësi të tjera të UT. Staf i akademik i angazhuar është i kualifikuar me grada shkencore dhe tituj akademik, të cilët janë ndër specialistët më të mirë të fushës.</p> <p><i>(Ref. CV e stafit)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe punën kërkimore të personelit akademik dhe njësisë bazë të Institutit të Studimeve Evropiane. Ky Institut është i dedikuar për studimet evropiane në tërësi dhe analizën e politikave dhe ofrimi i këti programi studimi është tërësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore. Ky program është në përputhje me legjislaçionin e arsimit të lartë në fuqi, me Statutin dhe aktet e tjera rregullatore të UT-së.</p> <p><i>(Ev. 2. Statuti UT Ev.7 Rregullore e Programit të Studimit.)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje</p>	<p>Gjithashtu fusha e përgjithshme është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të departamentit të Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të BE-së, i cili është përgjegjës për programin e studimit. Ky program studimi i përket nivelit të 7-të të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, dhe bazohet në standardet dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.</p> <p><i>(E. 2. Statuti UT, E.7 Rregullore e Programit të Studimit.)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p>Standardi I.5 Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe</p>	<p>ISE është një njësi ende e vogël në UT dhe gjatë vizitës u vu re se</p>

<p>mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>stafi ishte kolegjal, dashamirës dhe bashkëpunues me njëri tjetrin. Në tërësi ato vinin nga eksperiencia të gjata akademike dhe profesionale gjë që mundësonte një bashkëpunim profesional dhe të frytshëm. Nga pikpamja rregullatore, UT ka miratuar statutin e tij ku sanksionohet edhe pozicioni i ISE dhe ISE ka rregulloren e vet ku rregullohen proceset e brendshme. Gjithashtu, në bashkëpunim me rektoratin e UT, ISE ka vënë në jetë procedurat e kontrollit të brendshëm të cilësisë të cilat janë në institucionalizim e sipër. Çdo staf në fund të vitit akademik plotëson formularin me aktivitetin akademik dhe profesional dhe dorëzon një plan për vitin e ri. Ky dokumentacion përbën bazën vlerësimit të punës, ndarjes së detyrave dhe planifikimit të veprimtarive.</p> <p><i>(E. 2. Statuti UT, E.7 Rregullore e Programit të Studimit.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Siç e përmendëm edhe më sipër ISE ka bashkëpunime kryesisht me institucione qëndrore publike për zhvillimin e praktikave profesionale dhe aktiviteteve të tjera me profil akademik në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Përsa i përket marrëdhënieve ma jashtë, ISE, ndër të tjera ka fituar projektin Jean Monnet Chair dhe ditën e vizitës në institucion u firmos marrëveshja e bashkëpunimit me Kolegjin e Evropës në Belgjikë.</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani, të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Siç është përmendur më sipër, institucioni ka bashkëpunime të strukturuar me institucione publike qëndrore kryesisht për zbatimin e praktikave studentore por edhe për shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta. Këto bashkëpunime lehtësohen nga fakti që disa nga lektorët e programit vijnë nga bota profesionale dhe administrata publike ku kanë mbajtur pozicione të larta drejtuese. Një tjetër element që e lehtëson, punën e institucionit, është se shumica e studentëve të programit janë të punësuar, para se të regjistrohen në program.</p> <p><i>(Ref. Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në tërësi përgjigja më sipër mbulon edhe këtë kriter pasi programi nuk ka ndonjë natyrë specifike që të kërkojë rregullime dhe marrëveshje të veçanta për kryerjen e praktikës.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton bashkëpunim me institucione homologe apo institute kërkimore shkencore me qëllim realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit dhe</p>	<p>Gjatë vizitës, një nga studentët iu bashkua takimit online pasi ishte në shkëmbim Erasmus në Universitetin e Bolonjës, Itali. Ky ishte një nga treguesit e bashkëpunimeve të strukturuar të ISE me IAL ndërkombëtare. Gjatë dy viteve të fundit shkëmbimet</p>

studentëve.	kanë qenë minimale për shkak të COVID, por ato kanë rifilluar dhe me Jean Monnet Chair dhe marreveshjen me Kolegjin e Evropës, ndër të tjera, është e qartë që programi i studimit, dhe ISE në tërësi, në frymë dhe në gërmë, e përmbushin kriterin 5. <i>(Ref. takimi me drejtuesit e ISE dhe Departamentit)</i>			
Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit	Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga vizita në institucion, u vu re se nuk kishte një praktikë të veçantë në këtë kuadër, por më shumë zhvillohej <i>ad hoc</i> (sipas nevojës) ose në raportime tek donatorët në rastet e financimeve ndërkombëtare. Me shtimin e stafit si dhe me strukturimin e plotë të NJSBC, analiza të këtilla janë, ashtu siç duhet në fakt, përfshirë në planin e punës. <i>(Ref. takimi me drejtuesit e ISE dhe Departamentit)</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.6

Institucioni mbështet arritjet në studimet e thelluara dhe të kërkimit shkencor, të cilat promovohen dhe bëhen publike.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor, veprimtarive kërkimore shkencore të personelit akademik dhe studentëve.	I gjithë personeli akademik inkurajohet të publikojë artikuj dhe punime shkencore me cilësi të lartë në përmbushje të kërkesave të VKM 112. Puna kërkimore njihet si pjesë e ngarkesës akademike të detyrueshme që është një ndihmesë dhe lehtësim i madh për angazhimin e lektorëve në kërkim. ISE ka dhe instrumentat e saj të divulgimit të punës kërkimore ku stafi akademik mund të publikojë falas. Gjithashtu të gjitha referimet në konferencat shkencore të organizuara nga ISE publikohen e shpërndahen falas. <i>(Ref. takimi me stafin akademik)</i>
Kriteri 2. Institucioni ngre një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor.	Rezultatet e punës kërkimore analizohen në nivel departamenti dhe njësie kryesore kryesisht në fund të semestrit dhe vitit akademik. Me konsolidimin e plotë të NJSBC edhe kjo analizë mund të behet pjesë e produkteve periodike që zhvillojnë departamentet dhe njësia kryesore. <i>(Ref. takimi me drejtuesit e ISE dhe Departamenti, stafin akademik)</i>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë për promovimin e rezultateve në fushën e kërkimit	Siç e thamë më sipër, ISE i publikon punimet akademike si dhe 'proceedings' të konferencave shkencore. Gjithësesi një punë më e

shkencor.	mirë mund të bëhet për 'outreach' dhe krijimin e një profili më publik për ISE sidomos duke patur parasysh stafin e kualifikuar, me profil publik dhe me eksperiencë në administratë publike. (Ref. takimi me stafin akademik)			
Kriteri 4. Institucioni ndjek një politikë për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, si dhe praktikën e mirë në veprimtarinë kërkimore-botuese.	Në lidhje me kriterin 4 institucioni ndjek politikën e IAL. Duke qenë që në ISE nuk ka kërkim të aplikuar, çeshtjet e pronësisë intelektuale nuk janë shumë të prekshme, gjithësesi, ndiqet statuti i UT dhe ligji. (Ref. takimi me stafin akademik, E.2 Statuti i UT)			
Kriteri 5. Institucioni inkurajon studentët dhe kërkuesit e rinj për ndërmarrjen e iniciativave vetjake në fushën e kërkimit shkencor	Studentët janë përfshirë në punën kërkimore të pedagogëve dhe gjithashtu ka patur konferenca ku janë përfshirë studentë referatet e të cilëve janë publikuar në 'proceedings'. Gjithësesi ne nuk pamë ndonjë artikull në bashkë-autorësi me studentë dhe mendojmë që më shumë mund të bëhet për inkurajimin dhe përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor bashkë me pedagogët. (Ref. takimi me studentët)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module, të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit MSH në "Politika dhe qeverisja në evropë" e përmbush kriterin 1 pasi është program i ciklit të dytë i organizuar në module/lëndë të cilat kanë kreditet përkatëse ECTS, në përfundim të të cilit lëshohet diploma master i shkencave. Siç jemi shprehur dhe më sipër, programi ka 120 ECTS, zhvillohet në dy vite akademike të ndarë në 4 semestra dhe zbaton përcaktimet ligjore që burojnë nga legjislacioni i arsimit të lartë. Ndarja në kategoritë përkatëse, ndarjet e orëve për çdo lëndë me kreditet përkatëse për çdo semestër,

	<p>përcaktohen në rregulloren e programit dhe planin mësimor të tij dhe reflektojnë kërkesat e akteve nënligjore në fuqi të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p><i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit dhe E.11- Plani mësimor i programit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” synon formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Programi synon të formojë studentë me njohuri në fushën e diplomacisë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të BE. Studentët që ndjekin këtë program studimi kanë mundësi të punësohen apo të vijojnë karrierën e tyre profesionale (pasi shumica janë të punësuar kur regjistrohen në ISE) kryesisht në institucione publike qendrore të cilat duhet të njohin strukturat/rreguloret e BE dhe harmonizohen gradualisht me to. Gjithashtu programi i mundëson studentëve të cilët kanë interes të vijojnë studimet e ciklit të tretë.</p> <p>Lëndët dhe veprimtaritë mësimore të programit lidhen harmonikisht me objektivat formues të programit të studimit. Kur të zhvillohet një studim më i strukturuar i tregut të punës, siç sugjeruam më sipër, këto veprimtari dhe objektiva mund të rishikohen nën prizmin e të dhënave të përftuara.</p> <p><i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Ky program studimi synon të:</p> <ol style="list-style-type: none"> Pajisë të diplomuarit me njohuri të thelluara në politikë-bërjen në vendet e BE dhe institucionet e BE; Aftësojë studentët të formojnë pikëpamjet e tyre dhe të gjenerojnë analiza për çështjet e rëndësishme të procesit të integritimit evropian; Japë njohuri mbi krijimin e BE, evolucionin e institucioneve evropiane dhe kompleksitetin dhe dinamikat që ndikojnë në procesin e integritimit në BE. Pajisë të studentët me njohuri dhe aftësi metodologjike në politikë-bërjen në BE. <p>Në tërësi lëndët dhe sylabuset reflektojnë mire këto objektiva në leximet që japin për studentët, detyrat përkatëse si dhe aktivitetet në klasë. Siç thamë edhe më sipër, përditësimi në kohë reale i teksteve bazë është shumë i rëndësishëm pasi është një fushë që ndryshon shumë shpejt. Gjithësesi GVJ e mirëkupton vështirësinë dhe kostot e qenësishme të përkthimit në kohë të literaturës.</p> <p><i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit dhe sylabuset specifike).</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e</p>	<p>Siç u shprehëm edhe më sipër, programi i studimit i ofron studentëve njohuritë e nevojshme për të përvetësuar kompetenca teorike dhe praktike. Në tërësi, në këtë program studimi studentit i mundësohet përvetësimi i njohurive të thelluara dhe aftësimi profesional me qëllim përshtatjen, sa më shumë të jetë e mundur,</p>

<p>problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>nevojave të tregut të punës si dhe zhvillimeve të vendit. <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit dhe E.11 – Plani mësimor i programit të studimit).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” përmban të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimit është pjesë e ciklit të dytë të studimeve dhe përmban elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit në përputhje me kriteret e vendosura në VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018. <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit dhe E.11 – Plani mësimor i programit të studimit).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Programi i studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve” ka të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët / modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Ky program organizohet në module/lëndë me kredite ECTS dhe lëndët grupohen sipas VKM Nr. 41, dt. 24.01.2018 si vijon: A. Lëndë bazë që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme – 2 lëndë, 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve); B. Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik – 10 lëndë, 60 kredite ECTS (50 % e totalit të krediteve); C. Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup-lëndë me zgjedhje – 3 lëndë me zgjedhje, 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve); D. Lëndë plotësuese - praktikat profesionale – 12 kredite ECTS (10 % e totalit të krediteve të këtij programi); E. Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës – 18 kredite ECTS (15 % e totalit të krediteve). <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit dhe E.11 – Plani mësimor i programit).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit ka të përcaktuar kreditet për realizimin e diplomës dhe aktivitetet kërkimore në kuadër të zhvillimit të saj</p>	<p>Programi i studimit e përmbush edhe kriterin 7 pasi ka 120 kredite ECTS dhe kohëzgjatje 2 vite akademike sipas detyrimeve ligjore. Në këtë program detyrimet përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës, kanë 18 kredite ECTS ose 15 % e krediteve. Teza e diplomës është punë e pavarur në formën e një studimi analitik që lidhet me formimin e marrë gjatë programit. Teza e diplomës përmban një sërë kriteresh vlerësimi që jep mundësi studentit, nëpërmjet punës hulumtuese, të dëshmojë aftësinë për të kryer studime në fushën e politikë-bërjes dhe studimeve evropiane. Në përfundim të diplomimit, studenti pajiset me diplomën përkatëse Master i Shkencave. <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit, neni 6/6/E dhe neni 25)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.2**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Përsa i përket këtij kriteri, GVJ vë në dukje që ISE është një organizim i veçantë i një njësie kryesore pasi është ndërfakultetore. ISE ka fokus kryesisht kërkimor në fushën e studimeve evropiane si një nga fushat prioritare të Shqipërisë. Organizimi i ISE bazohet në legjislacionin për arsimin e lartë në fuqi, statutin e UT-së dhe aktet e tjera nën-ligjore. Aktualisht ISE në strukturë ka 2 departamente siç sanksionohet edhe në statutin e UT neni 20 pika 4. Duke qenë që ky status është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, GVJ e vlerëson organizimin e njësisë kryesore në përmbushje të detyrimeve ligjore.</p> <p><i>(E.2 – Statuti i UT; E.7 – Rregullore e Programit të Studimit; E.5 – Plani i Zhvillimit të ISE 2021-2024).</i></p>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	<p>Personeli akademik i angazhuar në program përbëhet nga personel akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme me tituj akademik e grada shkencore. GVJ vëren se stafi akademik i përfshirë në realizimin e programit është me formimin e duhur, me grada e tituj dhe – bazuar në takimin me studentët – profesional e i disponueshëm.</p> <p>Gjithësesi, departamenti që ofron programin e studimit në momentin e vizitës nuk përmbush numrin e kërkuar nga ligji për staf me kohë të plotë pasi kishte pasur disa largime. departamenti kishte vetëm 6 anëtarë. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se për shkak të specifikave që ka ISE, si njësi kryesore ndërfakultetore, realizimi i programit të studimit bëhet duke angazhuar staf me kohë të plotë nga njësi të tjera të UT. Gjithashtu u informuam se në vitin e ri akademik 2022-23 do të bëheshin rekrutime të reja, për të përmbushur kriterin ligjor. Thënë këtë, GVJ vëren pozitivisht shtimin e stafit akademik vitet e fundit i cili, në tërësi, është i formuar në vende të BE.</p> <p><i>Për gjithë sa më sipër, GVJ sugjeron që ISE të hartojë një plan pune dhe një buxhet shoqërues për hapat që do të ndërmerren për plotësimin e organikës së departamentit me staf me kohë të plotë sipas specifikimeve ligjore.</i></p> <p><i>(E.2 – Statuti i UT; Aneks RVB-tabelat përmbledhëse)</i></p>
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjeshme dhe të ftuar.	<p>Bazuar në tabelat përmbledhëse të dorëzuara nga institucioni, stafi akademik për programin e studimit për vitin akademik 2021-2022 është i gjithi me tituj e grada. Në tërësi, GVJ vëren se ISE ka angazhuar burime njerëzore të kualifikuara në përputhje me profilin dhe kërkesat e programit të studimit.</p> <p><i>(Aneks RVB-tabelat përmbledhëse)</i></p>

Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	ISE si dhe njësitë bazë përbërëse të tij janë në përputhje me Statutin e UT i cili është miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin.			
Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, projekteve studimore e kërkimore etj.	Programi i studimit, për nga vetë natyra e tij kryesisht teorike, nuk ka në përbërje të tij praktika mësimore apo orë laboratorike/klinike. Ndrkohë, praktikat profesionale janë të mirë strukturuar, pjesë përbërëse e kurrikulës dhe ndiqen nga staf akademik i cili është i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimit.			
Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për programin e studimit është miratuar koordinatori i programit me urdhër të drejtorit të ISE-së i cili përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarive mësimore dhe ato kërkimore që zhvillohen në program. Në rregulloren programit përcaktohen përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të Programit të Studimit. <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit; E.21- Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit).</i>			
Kriteri 7. Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit	Koordinatori i programit të studimit, në lidhje me ecurinë e programit dhe praktikave profesionale raporton tek drejtori i ISE. Nga vizita në institucion GVJ u që, duke qenë se institucioni është i vogël dhe numri i studentëve po ashtu, raportimet janë bërë gjatë mbledhjeve periodike të departamenteve dhe jo domosdoshmërisht me raporte me shkrim. <i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit; E.21- Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.3

Programi i studimit MSH/MA është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	ISE është njësi kryesore e UT, e cila është IAL më e vjetër dhe më e madhe në vend me struktura të institucionalizuara. Duke analizuar dokumentacionin e dërguar, bazuar edhe në vizitën në institucion, GVJ vëren se ISE ka informacionet në lidhje me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit. Siç jemi shprehur edhe më sipër, programi i studimit, bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018, i ndryshuar ka: a) kreditet ECTS; b) kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit; c) objektivat formues dhe kompetencat profesionale; ç) veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të

	<p>programit të studimit; d) kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi; dh) planin mësimor; e) kuotat e pranimit; ë) programin lëndor; f) profilin e programit; g) diplomën dhe suplementin Për gjithë sa më sipër, GVJ vëren se kriteri 1 plotësohet.</p> <p><i>(E.7 – Rregullore e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit organizohet në lëndë, module, praktike e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Siç jemi shprehur disa herë edhe më sipër, programi i studimit i përket ciklit të dytë dhe organizohet në lëndë me ECTS. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike: leksione; seminare; punim esesh, detyrash apo projektesh; prezantime, provime; përgatitje për provime; përgatitje e tezës së diplomës; praktika profesionale.</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Siç jemi shprehur disa herë edhe më sipër, ndarja e orëve mësimore në auditor në leksione e seminare përcaktohet në planin mësimor të programit të studimit në bazë të krediteve sipas kriterëve të specifikuar në aktet nën ligjore. Në përfundim të studimeve studenti duhet të grumbullojë 120 ECTS. Viti akademik është i ndarë në dy semestra me kohëzgjatje 15 javë çdo semestër.</p> <p><i>(E.7 – Rregullorja e Programit të Studimit)</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacion i nevojshëm për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Plani mësimor zbaton kriteret e vendosura në VKM nr. 41, datë 24.01.2018. Në planin mësimor detajohen lëndët - të ndara sipas kategorive formuese si dhe në vite e semestra - dhe kreditet përkatëse. Plani detajon gjithashtu ngarkesën mësimore, orët në dhe jashtë auditorit, frekuentimin e lëndëve dhe vlerësimin e dijeve.</p> <p><i>(E.7 - Rregullorja e Programit të Studimit; E.11 – Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 5. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Ky program ka detajuar në rregulloren e tij - bazuar në kriteret ligjore - dhe i ka publike, elementet që kanë të bëjnë me kriteret e pranimit dhe transferimit. Në varësi të kuotave të akorduara nga ministria e arsimit, ISE pranon transferime nga IAL të tjera vendase ose të huaja. Njohja e plotë ose e pjesshme e krediteve merret nga komisioni i posaçëm i ngritur nga drejtori i ISE-së, bazuar në rregulloren e programit dhe të UT.</p> <p><i>(E. 7- Rregullorja e Programit të Studimit; E.20 – Kriteret e pranimit ISE)</i></p>
<p>Kriteri 6. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore</p>	<p>Kriteri 6 plotësohet pasi, bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe vizitën në terren, programi ka syllabuset për secilën lëndë, për praktikat, dhe seminarët. Për syllabuset</p>

(syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	dhe praktikën respektohen formatet e miratuara për këtë qëllim në VKM nr. 41 datë 24.01.2018. Për praktikën, ISE ka miratuar formularin specifik të vlerësimit të praktikës. (E.7 - Rregullorja e Programit të Studimit; E.11 – Plani mësimor i programit të studimit; E.12 – Syllabuset e lëndëve; E.7/2 – Formularë për vlerësimin e praktikës profesionale)			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht	Institucionit i lejohet që deri në masën 20 % të përmbajtjes së programit, të shprehur në kredite ECTS, me miratim të Senatit të ndërmarrë ndryshime. Bazuar në dokumentacionin e dërguar por edhe nga vizita në institucion, ndryshime të tilla nuk ka patur vitet e fundit. Por në fillim të çdo viti akademik syllabuset përditësohen. Siç jemi shprehur më sipër, kujdes i veçantë duhet bërë me përditësimin e literaturës pasi është një fushë që ndryshon shumë shpejt. (E.7 - Rregullorja e Programit)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit “Master i Shkencave”/“Master i Arteve” është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Siç jemi shprehur disa herë më sipër, programi është organizuar në leksione, seminare dhe praktika profesionale me kredite ECTS bazuar në VKM 41 datë 24.1.2018. Në tërësi, GVJ vëren se organizmi dhe zhvillimi i programit dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore ETCS i mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit dhe përfundimin aftësive profesionale. (E.7 - Rregullorja e Programit të Studimit, nene 5-10)
Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	GVJ vëren se emërtimi i programit është i përshtatshëm me përmbajtjen dhe shpërndarja e lëndëve dhe praktika mundëson përmbushjen e objektivave të programit dhe aftësimin e studentëve në studimet evropiane. Siç kemi thënë edhe më sipër lëndët e programit dhe syllabuset janë të krahasueshme me programe të ngjashme në BE dhe i ofrojnë studentëve mundësinë të fitojnë aftësi përmbajtësore dhe profesionale që t’i bëjnë ato të përshtatshëm me tregun e punës. (E.14 – Raporti vjetor i ISE)

<p>Kriteri 3. Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>GVJ vëren, siç ka vërejtur edhe më sipër, që lëndët dhe shpërndarja e tyre i mundësojnë studentëve pajisjen dhe zbatimin në praktikë të aftësive metodologjike dhe njourive teorike të cilat përdoren në shkrikimin e eseve dhe temës së diplomës. Gjithashtu përfshirja në konferenca studentore është një element më shumë i aftësisimit metodologjik në praktikë. Të gjitha këto elemente së bashku lehtëson integrimin e studentëve në tregun e punës.</p> <p><i>(E.7 - Rregullore e Programit të Studimit; E.14 – Raporti vjetor i ISE-së 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit të studimit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori-praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Edhe për këtë çështje jemi shprehur disa herë. GVJ vëren se programi i studimit, në strukturë dhe përmbajtje, është i krahasueshëm me programe të gjashme ndërkombëtare.</p> <p><i>(E.11 – Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit, për nga vetë karakteri i masterit shkencor ka qasje teorike. Nga vizita në institucion, takimi me pedagogët dhe studentët, GVJ vuri re se në leksione përdorej gjërësisht metoda ‘case study’ në leksion e cila mundësonte gërshetimin e teorisë me situatë praktike. Duke patur parasysh edhe faktin që pjesa dërrmuese e studentëve kur regjistroehn janë të punësuar, kjo krijon mundësi edhe për diskutime dhe detyra të nivelit me praktik.</p> <p><i>(E.11 – Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 6. Syllabuset (programet e lëndëve/ moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Çdo lëndë ka syllabusin i cili përditësohet mbi bazën e zhvillimeve në fushën e studimeve evropiane, propozimeve të titullarit dhe diskutimeve në departament. Nga takimi me pedagogët e angazhuar në programin e studimit, GVJ vëren se ato bëjnë përpjekje për të pasuruar literaturën në syllabuset e lëndëve. GVJ tërheq vëmendjen që për disa lëndë për të cilat ndryshimet janë të shpeshta të bëhet kujdes i shtuar.</p> <p><i>(E.12–Syllabuset e lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programin e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Bazuar në analizën e kriterëve 2,3,4,5 dhe 6 GVJ vëren se edhe kriteri 7 përmbushet pasi në tërësi është derivat i tyre. Nga analiza sidomos e sylabuseve, GVJ vëren se ka përputhje midis titullit të lëndës, objektivave, literaturës dhe instrumentave të vlerësimit. Të gjitha këto përputhen me dhe mundvsojnë përfitimin e dijeve të një programi të ciklit të dytë.</p> <p><i>(E.12 – Syllabuset e lëndëve; E.7- Rregullorja e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 8. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë</p>	<p>Sipas ligjit të arsimit të lartë, diplomimi nga një program MSh i jep mundësinë studentit, nëse plotëson kriteret e tjera, të vijojë studimet e ciklit të tretë. Ky program studimi duke</p>

e kërkesat e tregut e punës.	ofruar edhe trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. Përsa i përket tregut të punës, jemi shprehur disa here më sipër, që programi ofron aftësi që mundësojnë punësim kryesisht në institucione qëndrore publike. (E.12 – Syllabuset e lëndëve)								
Kriteri 9. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.	ISE ka një sërë bashkëpunimesh me partnerë, kryesisht të institucioneve publike qëndrore. Nga bashkëpunimi me to, në mënyrë kryesisht <i>ad hoc</i> , mbledh informacion mbi përshtatshmërinë e programit dhe nevojave të tregut të punës. Por, siç e kemi thënë më sipër, duhet bërë një studim më i strukturuar i tregut të punës i cili gjithashtu të institucionalizojë në tej marrëdhënien me aktorët e tregut të punës. (E.14 – Raporti vjetori i ISE-së 2020-2021; E.31- Propozim ndryshimesh në planet mësimore)								
Kriteri 10. Kombinimi i veprimtarive të formimit teorik dhe shkencor, mundësojnë njohuri të avancuara për studime, kërkime, analiza dhe vijim të aktivitetit shkencor në ciklin e tretë të studimeve	GVJ vëren se në tërësi kriteri 10 plotësohet. Specifikisht, GVJ vëren se programi i studimit duke ofruar trajnim të avancuar në metoda kërkimi dhe duke patur si një detyrim edhe shkrimin e temës së diplomës, i përgatit studentët për jetën kërkimore që duhet të ndërmarrin si doktorantë. (E.7 -Rregullore e Programit të Studimit)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmësakademik që mbulon programin e studimit përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke përmbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementët e tjerë të programit të studimit. Pjesa kryesore e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë PAE i UT.
Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit “Master i shkencave”/“Master i arteve”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka kualifikimin me tituj akademikë e grada shkencore duke

mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

përbushur kërkesat ligjore dhe pritshmëritë e cilësisë akademike. Po aq e rëndësishme, stafi akademik në këtë program studimi angazhohet në proceset e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe gjithë elementeve të tjerë të programit të studimit. Pjesa kryesore e stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi janë PAE i UT.

Referuar të dhënave rezulton se ngarkesa mësimore mbulohet nga stafi akademik PAE mbi masën 70% - 85%, në të tre vitet që në disponojmë të dhënat.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, takimi me personelin si dhe takimi me studentët, GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet. Personeli akademik i angazhuar në këtë program ka kualifikime brenda dhe jashtë vendit, me tituj dhe grada shkencore, dhe të gjithë janë me eksperiencë në fushën e mësimdhënies, në administratë dhe në sistemin e drejtësisë.

Bazuar në të dhënave për vitin akademik 2021-2022 ngarkesa mësimore e stafi të angazhuar në këtë program studimi varion nga 195 - 495 orë, në të gjitha programet mësimore ku stafi është i angazhuar. Numri i lëndëve që ata mbulojnë është 3 ose 4 dhe janë përputhje me fushën e tyre të studimit, gjithashtu lëndët janë vazhdim ose thellim i njëra – tjetrës. Në CV-të e tyre gjenden ekspserienat dhe kualifikimet e nevojshme që përputhjen me fushën e përfshirë në mësimdhënie

GVJ vëren se mbulimi i ngarkesës mësimore dhe norma përkatëse respekton raportin PAE/PAK bazuar në Udhëzimin nr. 29, datë 10/09/2018 të MASR.

Bazuar në të dhënat tabelore të dërguar nga IAL reulton se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi ka pasur kualifikimin si më poshtë:

Personeli i angazhuar në zhvillimin e programit të studimit	Viti akademik 2021-2022		Viti akademik 2020-2021		Viti akademik 2019-2020	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof Dr					2	1
Prof.Assoc	2		2		1	
Dr/Doc	6	1	6	1	2	2
Msc (Dr në proces)						
Msc						
Në total	8	1	8	1	5	3



	<p>Ajo që vihet re nga të dhënat tabelore është se në këtë program studimi angazhohen staf i kualifikuar me tituj dhe grada në përputhje me kriteret ligjore.</p> <p><i>(E.11 – Plani mësimor i programit të studimit; E.13-CV e stafit akademik; Aneks RVB–Tabela përmbledhëse)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik, që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Në vijim të sa më sipër, GVJ vëren se kriteri 3 plotësohet. Fushat akademike të përgjithshme dhe specifike të stafit akademik kanë përputhje si me programin e studimit ashtu edhe me lëndët specifike që ato mbulojnë. Siç u shprehëm më sipër, eksperiencia akademike ndërthuret mirë edhe me atë profesionale duke e shtuar gamën e informacionit që ofrohet për studentin.</p> <p><i>(E.11- Plani mësimor dhe E.13-CV e stafit akademik).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se departamenti ka angazhuar pedagogë të posaçëm për mbikëqyrjen e praktikës e cila zhvillohet në institucione me të cilat ISE ka marrëveshje bashkëpunimi. E njëjta praktikë ndiqet edhe për udhëheqjen e diplomës për të cilën angazhohet staf akademik me tituj dhe grada pedagog PAE të ISE/UT. Në këtë kuadër puna e studentëve drejtohet edhe nga Udhëzuesi për përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës në programet e ciklit të dytë në ISE</p> <p><i>(E.28 – Vlerësim Marrëveshje bashkëpunimi të ISE-së)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimorshkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi nuk ka orë laboratorike e laboratorë të dedikuar pasi ka natyrë teorike dhe jo aplikative. Kësisoj, në tërësinë e tij, kriteri 5 nuk gjen shumë hapësirë për zbatim e nuk ka të njëjtën peshë specifike si kriteret e tjera të fushës II.5. Gjithësesi, GVJ dëshiron të vërë në dukje, bazuar në vizitën në institucion, se shërbimi IT ka nevojë të rrisë performancën dhe angazhimin profesional. Nga vështirësitë teknike me të cilat GVJ u përball për t'u lidhur online me ekspertin ndërkombëtar të vlerësimit të angazhuar në këtë program studimi - gjatë të dy ditëve të vizitës - shoqëruar me indiferencën e specialistit të IT, GVJ thekson nevojën e një qasje më profesionale.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Standardi II.6 Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbytjes së programit të studimit dhe</p>	<p>GVJ është shprehur edhe më sipër se përsa i përket</p>

<p>për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>anagzhimit me tregun e punës ka dy realitete. Së pari, të diplomuarit e programit të studimit janë thuajse të gjithë të punësuar dhe një pjesë e mirë kur regjistrohen janë të punësuar. Kjo është një pikë shumë e fortë e programit pasi tregon që ka reputacion dhe besueshmëri jashtë akademisë. Por, dokumenti që u dorëzua si studim i tregut të punës në tërësi ishte i paplotë dhe nuk gjetëm evidenca të plota për anagzhimin e partnerëve të tregut të punës në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programit. GVJ thekson që komunikime dhe vjelje mendimi ka, por një proces i strukturuar për ta zhvilluar këtë proces, me aq sa ne ishim në gjendje të kqyrnim, ende nuk ekziston dhe kjo duhet adresuar.</p> <p><i>(E.14 – Raporti vjetori i ISE-së 2020-2021 dhe E.15 – Analizë e Tregut të Punës).</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime në kuadër të përmirësimit të programit të studimit edhe studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen, nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se kriteri 2 plotësohet. Nga takimi me studentët u informuam se ato kishin një sërë instrumentash në dispozicion, formalë dhe informalë, për të dhënë mendimin e tyre për programin e studimit, literaturën në dispozicion si dhe qasjen didaktike. Studentët vlerësonin natyrën jo-formale të qasjes së ISE e cila i ndihmonte ato në komunikimin me pedagogët. Këto diskutimi përfshinin edhe orarin e lëndëve për t'i mundësuar të gjithë studentëve pjesëmarrje në klasë.</p> <p><i>(Takimi me studentët dhe E.16 - Rregullore dhe manuali për Sigurimin e Cilësisë në UT).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programit të studimit.</p>	<p>Nga takimet në institucion, GVJ u informua se, ISE përpiqet të ruajë kontaktet me studentët e diplomuar dhe kontakton në mënyrë të herëpashershme me ta, për të gjurmuar të diplomuarit si dhe për të ruajtur lidhjet me universitetin. Gjithësesi, GVJ nuk ishte në gjendje të identifikonte evidenca në lidhje me këto veprimtari dhe as struktura të brendshme të cilat e kishin përgjegjësi këtë veprimtari. GVJ mendon se marrëdhënia me alumni ka nevojë për më shumë vëmendje dhe burime.</p>			
<p>Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucione kërkimore e shkencore, publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme me fushë specifike studimi e kërkimi</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se ISE ka shtuar përpjekjet për të përditësuar dhe përshtatur programet e studimit me kërkesat dhe nevojat e partnerëve të saj. Kjo është qasja e duhur dhe GVJ e përshëndet dhe inkurajon atë. Gjithësesi, ne nuk ishim në gjendje të identifikonim një zbatim të kësaj qasje deri në momentin e vizitës në institucion.</p> <p><i>(E.14 – Raporti vjetori i ISE-së 2020-2021 dhe E.5– Plani i Zhvillimit të ISE)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi II.7**Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>GVJ vëren se ISE bazon punën kërkimore në Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022) si dhe Strategjinë e Zhvillimit të UT (2018-2023). Programi ka objektiva të qarta që formësojnë dhe reflektohen në planin mësimor dhe sylabuset e lëndëve. Puna kërkimore në ISE shihet si mjet për të rritur njohurinë mbi proceset e integrimi evropian dhe gjithashtu so mjet pvr të mundvsuar mësimdhënien e bazuar mbi dijet më të fundit. Pavarësisht situatës me fillimin e pandemisë, stafi akademik ka arritur të angazhohet në aktivitete shkencore dhe kërkimore (konferenca, botime, projekte, ekspertiza etj).</p> <p><i>(E.14 – Raporti vjetor i ISE-së 2020-2021; E.15 – Analizë e tregut të punës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>GVJ vëren se drejtimet kryesore kërkimore të ISE dhe programit të studimit bazohen në <i>Planin e Kërkimit Shkencor të UT (2018-2022)</i> dhe <i>Planin e Zhvillimit të ISE (2021-2024)</i>. Stafi akademik ka detyrim vjetor raportimin e outputit kërkimor dhe ngarkesa kërkimore i njihet si pjesë e normës. Pavarësisht se nuk ka mbështetje specifike financiare për kërkimin, në formën e granteve të dedikuara. ISE ofon mbështetje logjistike dhe mundësi pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, shkëmbime dhe koferenca.</p> <p><i>(E.5– Plani i Zhvillimit të ISE-së 2021-2024; E.14 – Raporti vjetor i ISE-së 2020-2021)</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>GVJ vëren se ky program studimi synon të pajisë të diplomuarit me njohuri teorike e metodologjike mbi politikat e Bashkimit Evropian që mundësojnë punën e pavarur kërkimore dhe integrimin në tregun e punës.</p> <p>Studentët janë përfshirë në një sërë shkëmbimesh në projekte Erasmus+ dhe bashkëpunime bilaterale me Fakultetin e Shkencave Sociale, Universiteti i Brno-s, Republika Çeke; Avokatin e Popullit, Agjencinë e Prokurimit Publik; dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale. Gjithasheu edhe marrëveshje të reja me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Kolegji i Europës, Belgjikë; dhe Universiteti i Molise-s, Itali (në proces) e shton gamëm e mundësive për studentët. Po ashtu, janë zhvilluar dy kurse trajnimesh të thelluara për studentët si: “EU Integration - Background & Perspective” (3 ECTS), me Profesor Hubert Petit, ish-zv.ambasador i BE-së në Tiranë, dhe Shkolla dimërore “EU meets China, Understanding the EU-China Relationship”, organizuar nga ISE në bashkëpunim me Institutin “Konfuci”.</p> <p><i>(E.5– Plani i Zhvillimit të ISE-së 2021-2024; E.14 – Raporti</i></p>

	<i>vjetor i ISE-së 2020-2021)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit fokusohet në hartimin dhe zbatimin e politikave studimore e shkencore rajonale dhe kombëtare.	Ky program studimi duke qenë se është cikël i dytë MSH, fokusohet në përçimin e aftësive metodologjike dhe teorike për kërkim shkencor të aplikuar. Thuajse të gjitha lëndët përfshijnë kërkim të pavarur studentor të reflektuar në ese kërkimore. Gjithashtu programi ka edhe temën që duhet përmbullur në fund të studimeve e cila është një kërkim i thelluar shkencor i ngjashëm me shkrimet e artikujve shkencor. Në tërëri, GVJ vërv se studentëve i krijohen mundësitë dhe i ofrohet mbështetja për kërkim shkencor që i bën të volitshëm për tregun e punës dhe i mundëson vijimin e studimeve. <i>(E.7 - Rregullorja e Programit të Studimit).</i>			
Kriteri 5. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administrohet nga ardhurat nga aktivitete të ndryshme	ISE si pjesë e UT varet financiarisht nga UT pasi edhe të ardhurat që mund të gjenerojë vetë, bazuar në rregullat e thesarit të shtetit, administrohen në nivel qendror. Edhe UT, si institucionet e tjera publike të arsimit të lartë në Shqipëri, vuajnë nga financimi i pjeshshëm i kërkimit shkencor pasi fondet janë të limituara. Fatmirësisht, ISE e ka tejkaluar këtë kufizim nëpërmjet programeve ndërkombëtare dhe fokus kërkimin e aplikuar. Përfshirja në projekte ndërkombëtare të cilat janë përmendur më sipër i ka mundësuar ISE të ketë output kërkimor përtej financimit të UT. <i>(E.2 – Statuti i UT).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.8

Institucioni i arsimit të lartë nëpërmjet programit të studimit garanton njohuri të thelluara, studime dhe kërkim shkencor, ndërkombëtarizim të studimeve dhe kërkimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Siç e kemi thënë edhe më sipër ISE ofron mbështetjen maksimale të mundshme brenda tavaneve buxhetore. Aty ku kufizimet buxhetore janë të atilla që nuk lejojnë kryejren e aktiviteteve kërkimore, aplikohet për projekte ndërkombëtare që, ndër të tjera financojnë edhe kërkimin e aplikuar. Për sa më sipër, GVJ vërv se ISE ka pjesëmarrje në rritje të partneriteteve dhe bashkëpunimit ndërkombëtar me aktorë me reputacion të lartë kërkimor si Jean Monnet Chair apo Kolegji Evropës. <i>(E.5 – Plani i Zhvillimit të ISE-së 2021-2024)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin	Nga vizita në institucion u informuam për bashkëpunimin e ISE me institucione publike i cili lehtësohet edhe nga fakti që një pjesë e mirë e pedagogëve kanë drejtuar institucione publike. Gjithashtu, nëpërmjet internshipeve, ISE ndihmon institucionet

akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	publike me studentë ekselentë duke i mundësuar atyre që edhe të marrin eksperiencë. Për më tepër njësia bazë ka aplikuar dhe është miratuar hapja e një masteri ekzekutiv për negociatat me BE i cili do të mishërojë angazhimin akademik të ISE me një impakt direkt në politikë bërje. (E.5 – Plani i Zhvillimit të ISE).			
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave	GVJ vëren se, ISE ka zhvilluar aktivitete si: konferenca, leksione të hapura, seminare, forume dhe tryeza debati me të ftuar vendas apo të huaj ku kanë marrë pjesë stafi akademik dhe studentë të këtij program studimi. Ka patur lektorë të huaj nga Universiteti i Dublinit, Irlandë, lektorë nga OSBE, si dhe lektorë dhe shkëmbime shkencore në kuadër të Jean Monnet Chair dhe Module. Këto aktivitete forcojnë kontaktet dhe rrisin mundësinë e bashkëpunimit në projekte dhe aktivitete vendore dhe ndërkombëtare. (E.14 – Raporti vjetori i ISE-së 2020-2021)			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve moduleve.	Institucioni e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standartet e vendosura nga UT dhe ato shetërore të cilësisë duke harmonizuar leksionet në kohë reale me ato të vëna në dispozicion nga pedagogu online. Në nivel institucional IAL-ja përdor sistemin Teams (LMS - Learning Management System), i cili i bën të mundur studentit në kohë reale të ketë qasje on-line me materialet e e përgatitura nga pedagogu si p.sh. leksione, materiale shtesë audiovizive, si dhe të kryejë vlerësimet për elementë të caktuar të mësimdhënies. Gjithashtu në nivel program-studimi UT ka vënë në dispozicion edhe udhëzuesin e pedagogut për përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative

	<p>të mësimdhënies</p> <p><i>(Ref. E.24 – Udhezues i UT-së për mësimin në distancë; E.27 Manual për përdorimin e sistemit Team-Clean Score)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>UT konsideron se përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies mund të arrihet vetëm nëpërmjet operimit të mekanizma të monitorimit dhe vlerësimit të personelit akademik në mënyrë periodike. Vlerësimi kryhet nga i) studentët për elementët e mësimdhënies); ii) Monitorimin periodik të performances së personelit akademik dhe aftësive të mësimdhënies nga; iii) si dhe një formular i vetvlerësimit të punës mësimore dhe kërkimore. ISE ka ngritur edhe njësinë e saj të sigurimit të cilësisë ku një pedagog dhe një student shërbejnë si hallkë e bashkëpunimit me strukturat e tjera të garantimit të cilësisë.</p> <p><i>(Ref. E.108 - Mendimi i Drejtorit të ISE, eprori (Ref. E.18 – Manuali i Vlerësimit të Performancës, Ref. E.17. KPSC - Paketa e Instrumentave të Cilësisë).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Për të tërhequr mendimin e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve cdo vit organizohen pyetësorët e studentit në përmblylje të cdo simestri ndërsa gjatë pandemisë ky proces është organizuar online. Në rast ankimesh për mangësi procedurale studenti t'i drejtohet Përgjegjësit të ISE me një kërkesë me shkrim për ngritjen e një komisioni për shqyrtimin e kërkesës dhe për rivlerësimin e komponentit të ankimuar, ndërsa për rastet e ankimit të provimit, studenti përsërit të njëjtën procedurë duke iu drejtuar dekanit i cili ngre një komision rishqyrtimi.</p> <p><i>(Ref. E.6 Rregullore e UT nenet 50 dhe 51, Takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës, E.17. KPSC - Paketa e Instrumentave të Cilësisë, E.14. Raporti Vjetor i ISE 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Bazuar në të dhënat e siguruar nga këto vlerësime, KPSC - si struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor, ku përfshihen dhe rezultati i punës së personelit ndihmës akademik - harton raportin vjetor me anë të të cilit informon drejtuesit e njësive, e përmes tyre të gjithë stafin e UT rreth rezultateve të monitorimeve, në mënyrë që të merren masat e nevojshme për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. <i>Megjithatë struktura e sapokrijuar ka ende mangësi në përmbushjen e të gjitha hapave të kriterit dhe ato zbatohen në nivel institucional dhe jo në nivelin e ISE.</i></p> <p><i>(Ref. E.16 – Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 15-16).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe</p>	<p>Raportet e Vlerësimit të Performancës së personelit akademik shërben për të evidentuar temat për organizimin e trainimeve</p>



rezultateve të marra, promovon shembujt të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies	specifike lidhur me nevojat e stafit të UT, por edhe përdoret si bazë për vlerësimin e performancës së stafit si kriter për zbatimin e marrëdhënieve të punësimit i.e. kohëzgjatja, apo shpërblimi. Rezultatet e marra diskutohen edhe në mbledhjet e ISE edhe me pedagogët në mënyrë individuale në fund të vitit akademik kur kryhet vlerësimi i stafit akademik. (Takimi me zyrën e KPSC, Ref. E.14 – Raporti Vjetor i ISE 2021-2021; E.18 – Manuali i Vlerësimit të Performancës).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyra kurse, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Procesi i mësimdhënies dhe mësim nxënies harmonizon format tradicionale si leksionet, seminarët, apo detyrat e kursit, me projekte dhe praktikat profesionale duke mbajtur parasysh ngarkesën në orët mësimore të punës individuale dhe orëve në auditor. Për tematika specifike me interes për studentet dhe transmetimin e dijeve organizohen edhe leksione të hapura me eksperte vendas apo të huaj duke shfrytëzuar edhe platformat teknologjike. (Ref. E.7 – Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 6-10).
Kriteri 2. Personeli akademik duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.	Personeli akademik përpiqet që të përzgjedhë format më efektive të mësimdhënies duke patur parasysh orën e mësimin, karakteristikat e lëndës, numrin dhe nivelin e mësimnxënies së studenteve, literaturën në dispozicion, si edhe kombinimin e aspektit teorik me atë praktik. Si edhe në programet e tjera studimore të UT, studentët me nevoja të veçanta dhe/ose me sëmundje kronike nuk janë në asnjë formë apo mënyrë, subjekt i ndonjë forme diskriminimi, megjithëse në program nuk ka patur raste të tilla. (Takimi me Stafin Akademik dhe me studentët, E.12 – Syllabuset e Lëndëve; E11 – Plani mësimor i programit të studimit).
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënies,	UT mbështet personelin akademik në procesin e përmirësimit të mësimdhënies duke mundësuar përdorimin e mjeteve didaktike më të përshtatshme për tematikën e trajtuar përfshirë këtu edhe përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe trajnimet për përmirësimin e kompetencave pedagogjike. Auditorët janë të paisura me mjetet e nevojshme didaktike për të prezantuar video ilustruese për mësimdhënien, për të prezantuar leksionet,

objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.	ndonëse vazhdojnë përpjekjet për përmirësimin e mëtejshëm. <i>(Vëzhgimi i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj. E.3 Strategjia e Zhvillimit të UT 2018-2023 pika 1-mësimdhënia dhe studentet).</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.	Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie ka përvojën e duhur profesionale dhe akademike në shpjegimin/transmetimin e njohurive dhe koncepteve të cilat ofrohen nga ky program. Numri i PAE ka ardhur duke e rritur në dy vitet e fundit – në të dy departamentet klu mbështetet programi – nga 13 në vitin akademik 2018-2019, në 20 në vitin akademik 2020-2021.. Kualifikimet dhe eksperiencia e përfituar brenda dhe jashtë institucionit, trajnimet e ndryshme dhe publikimet mund të rriten më tej tanimë që ISE ka fituar tre projekte Jean Monet në të cilët përfshihet edhe kualifikimi i personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, në mënyrë që të jetë sa më kompetent në lëndën që zhvillon dhe në metoda didaktike që përdor. <i>(Ref. E.13 CV e stafit akademik; Takim me Stafin Akademik, (Ref. E.11 Plani Mësimor i Programit; E.108 Tabela përmbledhëse për stafin).</i>
Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	UT ka si pjesë të strategjisë përmirësimin e kurrikulës dhe përfshirjen e studenteve në këtë proces. Për këtë të qëllim shërben pyetëtori i studentëve që zhvillohet në fund të çdo semestri duke ruajtur anonimatën e tyre, si dhe fokus grupeve me studentët dhe përmes opinioneve e mendimeve që ata shprehin në mbledhjet e hapura të departamentit. Megjithatë studentët nuk janë plotësisht të qartë se si integrohen këto rezultate në kurrikulat e programit. Një analizë e rezultateve të përmbledhura të këtyre vlerësimeve i vihet në dispozicion personelit akademik të interesuar dhe autoritetet drejtuese nga ana e KPSC-së me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në të ardhmen. Vlen të theksohet se struktura e kontrollit të cilësisë funksionon më shumë në nivel institucioni se në nivelin e ISE duke qenë se është një strukturë relativisht e re. <i>(Ref. E.3 Strategjia e Zhvillimit UT 2018-2023 pika 1-mësimdhënia dhe studentet, Ref. Takim me studentët e programit të studimit, (Ref. E.16 – Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, neni 15-16)</i>
Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Zhvillimi i orëve mësimore bëhet nëpërmjet metoda interaktive dhe diskutime, për të nxitur mendimin kritik të studentit dhe dialogun me ekspertë të ftuar në auditor apo edhe nepermjet platformave online për ta bërë mësimdhënien më tërheqëse dhe efektive. Rëndësi gjithmonë e më e lartë i kushtohet azhurnimit të vazhdueshëm për sa i takon debatit akademik apo zhvillimeve më të fundit, të cilat kanë një rëndësi specifike në këtë program. Në fokus të vazhdueshëm duhet të mbahet përmirësimi i

	<p><i>kurrikulave me informacione sa më të azhornuara duke patur parasysh se në këtë tematikë literatura dhe kërkimi janë në evolucion të vazhdueshëm.</i></p> <p><i>(Ref. E.12 – Syllabus i Lëndëve, (Ref. Takim me studentët e programit të studimit).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre</p>	<p>Personeli akademik gjatë leksioneve dhe seminareve alternon metoda të ndryshme të mesimdhënies për të dhënë mundësi studenteve që të marrin pjesë në diskutime, të bëjnë analiza dhe të prezantojnë ato në mënyrë bindëse dhe të argumentuar. Në orët mësimore ofrohen për diskutim edhe shembuj dhe situata konkrete me qëllim që studentët të kenë mundësi të reflektojnë nëpërmjet aplikimit direkt kompetencat e zhvilluara si edhe të reflektojnë progresin e arritur në asimilin e programit Marredhenia mes pedagogeve dhe studentëve zhvillohet në respekt të rregullave të komunikimit dhe etikës institucionale</p> <p><i>(Ref. Takim me stafin akademik dhe me studentët e programit të studimit, Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Ambientet ku kryhet procesi mësimor plotësojnë standardet për të zhvilluar një mësimdhënie cilësisëre. Ambientet e dhe sallat mësimore kanë hapësirat e nevojshme, janë të pastra. Për këto shërbime dhe mirëmbajtjen e ambienteve të institucionit kujdeset stafi administrativ i dedikuar</p> <p><i>(Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor, por edhe praktikave.</p>	<p>Procesi mësimor zhvillohet në ambientet e rikonstruara dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për të siguruar nje aktivitet akademik cilësor. Programi ka në përdorim 4 salla mësimore, të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e pajisur me PC në mënyrë që studentët të kenë të aksesojnë bibliotekat online. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor dhe përfitojnë nga sistem çireless</p>

	<p>(Ref. E.14 Raporti Vjetor i ISE 2020-2021, Vëzhgim i mjediseve auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj. E.23 Infrastruktura Akademike; Takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Në funksion të procesit mësimor është një infrastrukturë informatike që plotëson nevojat e programit. Në dispozicion është vendosur platforma e Microsoft për aksesin online të materialeve akademike si për pedagogët ashtu edhe për studentët. Duke filluar nga ky vit, pedagogët dhe studentët mund të komunikojnë nëpërmjet sistemit informatik duke përdorur materialet online por edhe forumet e hapura ndërsa studentet mund ti kontrollojnë notat dhe materialin akademik online duke patur akses kudo që ndodhen</p> <p>(Ref. Takim me studentët e programit të studimit dhe me sekretarinë mësimore, E.23 Infrastruktura Akademik).</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse, e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara për programin e studimit.</p>	<p>E gjithë literatura bazë dhe ajo ndihmëse është vënë në dispozicion të studentëve si në formë fizike dhe digjitale. Ndërsa materialet kryesore mësimore të programit janë në gjuhën shqipe, mjaft materiale janë në dispozicion edhe në gjuhën angleze. Po ashtu ofrohet edhe mundësia për akses nga ana e studentëve e literaturës online dhe pa pagesë (e-library) duke i ofruar studentit mundësinë e shfrytëzimit të një databazë më të plotë dhe të azhurnuar, duke kombinuar literaturën bazë të detyrueshme dhe atë të rekomanduar e cila përgatitet nga pedagogu i lëndës. Pasurimi vazhdueshëm i literaturës së vënë në dispozicion garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, si dhe kërkimin shkencor të parashikuara për programin e studimit. Megjithatë, një kombinim më i mirë i literaturës bazë me atë të përditësuar të programit do të rriste më tej cilësinë e materialeve në dispozicion të studentëve.</p> <p>(Ref. Takim me stafin akademik të programit të studimit, E.23 Infrastruktura akademike, E.12 Syllabuset e Lëndëve).</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>ISE ka një marrëveshje bashkëpunimi me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, për shfrytëzimin e bibliotekës së këtij institucioni nga ana e programit, duke rritur në këtë mënyrë kapacitetet e literaturës që mund të shfrytëzohen nga studentët dhe pedagogët. Biblioteka është e pajisur me: libra hard copy, CD dhe tituj online. Librat në gjuhën shqipe përbëjnë 65% të fondit ndërsa 35% janë në gjuhën të huaj. Rreth 67 tituj përbëjnë fondin e periodikëve në gjuhët iangleze, franceze dhe italiane).</p> <p>(Ref. https://unitir.edu.al/biblioteka-online, E.29 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë, E.23 Infrastruktura akademike).</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies</p>	<p>Infrastruktura e bibliotekës por edhe bibliotekat online si:</p>

<p>dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>JSTOR, COBISS+, i ofrojnë studentëve dhe pedagogëve muynësinë për të shfrytëzuar një database kërkimor më të gjerë, si edhe mundësojnë akses në literaturën më të fundit bashkëkohore në lidhje me tematikat e programit. Një info më e detajuar mbi sasine dhe cilësinë e materialeve që mund të aksesohen online paraqitet fushën 4 të raportit.</p> <p><i>(Ref. https://unitir.edu.al/biblioteka-online).</i></p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Infrastruktura e bibliotekës me një sipërfaqe prej 35 m² dhe 25 vende studimi, si edhe ambjentet laboratorike të IT-së shfrytëzohen nga studentet në përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike si detyra kursi, prezantime kërkimore apo tezën e diplomës. Mbetet për tu parë mundësia e një salle studimi për studentët e ISE duke patur parasysh si kohën e punës së bibliotekës (08:00-16:00) ashtu edhe numrin e vendeve pasi kjo bibliotekë është në dispizicion edhe të studentëve të FHF.</p> <p><i>(Ref. E.30 Rregullore e bibliotekës</i></p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Në kushtet e zhvillimit të mësimit online dhe në vijim, stafi i IT te universitetit ka garantur që pedagogët dhe studentët e programit të studimit të kenë akses në përdorimin e LMS (Learning Management System) Microsoft Teams. Nga fillimi i vitit po rritet në mënyrë të vazhdueshme ofrimi nëpërmjet platformës i leksioneve, materialeve shtesë, vlerësimeve dhe kryesisht i gjithë komunikimi ndërmjet pedagogëve dhe studentëve zhvillohet përmes platformës LMS/Teams. Për të rritur aksesin dhe cilësinë e këtij komunikimi janë përgatitur dhe shpërndarë edhe manuale për aksesin dhe përdorimin e platformave online, duke u përqendruar tek një ekspozitë e metodave inovative në këtë drejtim- dhe po përmirësohet sistemi</p> <p><i>(Ref. E.27 Manual i përdorimit të Sistemit Teams-Clean Score, E.24 Udhëzim i UT për mësimin në distancë. E.23 Infrastruktura Akademike).</i></p>
<p>Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Personeli akademik dhe studentët përdorin MS Teams edhe për komunikime të brendshme si vlerësimi, notat, kontakte sqaruese për detyrat, shpërndarjen e materialeve mësimore si dhe çdo komunikim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e mësimore. Për këtë qëllim përdoren edhe adresat me domainin @unitir.edu.al</p> <p><i>(Ref. E.24 Udhëzim i UT për mësimin në distancë).</i></p>
<p>Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre</p>	<p>Përzgjedhja e temave të diplomave bëhet nga studentët bazuar në kërkesat që ata paraqesin dhe temat e propozuara nga stafi akademik i këtij programi. Mentorimi i studentit kryhet nga pedagogu përkatës duke respektuar kërkesat dhe detyrimet sipas standarteve të miratuara për këtë qëllim nga</p>

	<p>Udhëzuesi për përgatitjen e temës së diplomës, ndërsa mbrojtja zhvillohet përpara një komisioni të përbërë nga dy pedagogë të departamentit: të Diplomacisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të BE, dhe i Legjislacionit dhe Politikave të BE. Gjatë punimit të temës studentët duhet të ndjekin seminare ndihmëse për përgatitjen e tezës që ka për qëllim të ndihmojë studentët të zhvillojnë punimin e tyre</p> <p><i>(Ref. E.9 Udhëzuesi për Mirkotezën dhe diplomimin e studentit në ISE).</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimxënies në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Strukturat e ngritura në nivel institucional merren me kontrollin dhe monitorimin e cilësisë dhe drejtohen nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standarteve të Cilësisë (KPSC), i cili bashkërendon punën me njësinë e sigurimit të brendshëm dhe ofron ekspertizë në lidhje me proceset e sigurimit të cilësisë. Një paketë aktesh është adoptuar gjithashtu për Sigurimin e Cilësisë duke ndihmuar në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Përmes mobilitetit dhe trajnimeve të vazhdueshme të stafit akademik edhe falë pjesmarrjes në projektet ndërkombëtare ndiqet mundësia e përmirësimit të cilësisë nëpërmjet përfitimit të eksperiencës ndërkombëtare përmes mësimdhënies në universitete perëndimore, por edhe përmes pedagogëve të ftuar nga këto universitete për të dhënë mësim në IAL</p> <p><i>(Ref. Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, E.17 Paketa e Instrumentave të Cilësisë e UT, E.2 Statuti i UT, neni 41 dhe Kreu IX)</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes të personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programin e studimit që ofron.</p>	<p>ISE është njësia përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit “Politikat dhe Qeverisja në Evropë”. Për këtë qëllim grupi i Sigurimit të Cilësisë në nivel Departamenti harton një raport vjetor ku paraqiten analizat mbi cilësinë e programit dhe hapat që duhet të ndiqen për përmirësimin e tyre. Departamenti përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, garanton që mësimi të zhvillohet nga personeli me ekspertizën dhe kualifikimin e nevojshëm. Silabuset e hartuara miratohen nga përgjegjësi i departamentit, i cili bën vlerësimin e mësimdhënies, qoftë duke ndjekur zhvillimin e orëve të mësimin nga personeli akademik, qoftë duke inkurajuar studentët të</p>

	<p>raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar. Stafit akademik dhe studentët janë në djeni të procedurave të vlerësimit të mësimdhënies, duke rritur vetëdijen e tyre për cilësinë e mësimdhënies</p> <p><i>(Ref. Takim me drejtuesit e Departamentit të Diplomacisë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, si edhe të Legjislacionit dhe Institucioneve Europiane, E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë neni 13, neni 14. E.16 Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT).</i></p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti dhe strukturat ndihmëse në nivel UT mbështesin zbatimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies duke përdorur më gjerësisht nga fillimi i vitit teknologjinë informative si LMS. Megjithatë këto aktivitete zhvillohen në rrang universiteti ndërsa ISE është ne hapat e para në zbatimin e këtyre iniciativave.</p> <p><i>(Ref. E.16 Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Stafi akademik i angazhuar në përgatitjen e programit të studimit kombinon mësimdhënien me kërkimin shkencor për kualifikimin e mëtejshëm të stafit akademik në zbatim edhe të direktivave dhe rekomandimeve të paraqitura në Planin Shkencor të UT 2018-2022. Në këtë aspekt programi studimi po kryen më shumë aktivitete që nga fillimi i vitit duke përfituar edhe nga dy projektet Jean Monet. Një metodologji dhe procedurë e plotë se si zhvillohen konkretisht aktivitetet për trainimin e stafit, si evidentohen nevojat apo si zbatohen programet e trainimit nuk është ende i integruar në aktivitetin e ISE.</p> <p><i>(Ref. Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë, Ref. E.4 Pika 4-5).</i></p>
<p>Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Trajnimi i personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja zhvillohet në nivel institucioni, ndërsa në nivelin e ISE kryhet kryesisht nëpërmjet trainimeve tematike, periudhave të shkurtra të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në aktivitete në kuadër të projekteve KA1 Erasmus+, tavolina të rumbullakta, seminare me pjesëmarrjen e akademikëve të huaj dhe profesionistëve nga fusha dhe tematika të caktuara Edhe në këtë rast aktiviteti zhvillohet në nivel universiteti ndërsa ISE po punon në këtë drejtim duke patur parasysh edhe rritjen e numrit të PAE në dy vitet e fundit.</p> <p><i>(Ref. Takim me Zyrën e Projekteve dhe Partneriteteve, Zyrën e Standardeve dhe Cilësisë; E.24 Udhëzuesi i UT përpërdorimin e sistemit të mësimin në distancë).</i></p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe angazhohen për</p>	<p>Personeli akademik që është përgjegjës për zbatimin dhe cilësinë e mësimdhënies merr një ndihmë të vazhdueshme nga personeli ndihmës akademik për sigurimin e një procesi cilësor të</p>

<p>përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>mësimdhënies por edhe përmirësimin e mëtejshëm të këtij procesi. Pedagogu është përgjegjës për përgatitjen dhe azhornimin e syllabuseve, literaturës, si edhe të gjithë elementëve të tjerë tëparashikuar në procesin e mësimdhënies. Një metodologji dhe procedurë e plotë se si zhvillohen kokncretisht aktivitetet për përmirësimin e mësimdhënies nuk është ende e funksionale në ISE.</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë"; Rregullore e UT, nenet 27-29)</i></p>								
<p>Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Stafi akademik kërkon vazhdimisht aplikimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie duke zbatuar modele specifike si për shembull metoda më interaktive në tema të caktuara por edhe duke përdorur teknologjite e informacionit. Raportimi i rezultateve të aplikimit të metodave të reja në mësimdhënie kryhen nga vetë pedagogët dhe përfshihet në vetvlerësimin e përgjithshëm të performancës së punës së tyre mësimore dhe kërkimore. Megjithatë nuk ka ndonjë procedurë specifike dhe periodike të një analize mbi efektet dhe pritshmëritë.</p> <p><i>(Ref. E.18. Manuali i vlerësimit të performances, E.14 Raportimi i Analizës vjetore të ISE).</i></p>								
<p>Kriteri 8. Institucioni, në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor, angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor</p>	<p>Në funksion të përmirësimit të procesit të mësimdhënies, programi ka përfshirë në procesin e mësimdhënies lektorë të ndryshëm vendas apo të huaj, falë bashkëpunimeve në kuadër të programeve të bashkëpunimit. Janë zhvilluar edhe kurseve të trainimeve të vazhduara si për shembull: "EU Integration – Background and Perspectives"; shkolla dimerore "EU meets China: Understanding the EU China Relationship". Këto inisiativa janë pjesë e një bashkëpunimi më të gjerë të ISE me perfaqësitë diplomatike dhe organizmat ndërkombëtare të akredituara në Tiranë, sic janë: Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, OSBE, etj. Megjithatë, një intensitet më i madh aktivitetesh do të ishte i mundur duke patur parasysh interesin që kanë aktorë vendas dhe të huaj në fushën e studimit të programit.</p> <p><i>(Ref. E.28 Vlerësimi i marrëveshjeve të Bashkëpunimit ISE).</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="574 1478 742 1545">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="742 1478 957 1545">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="957 1478 1173 1545">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1173 1478 1386 1545">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="574 1545 742 1601"></td> <td data-bbox="742 1545 957 1601"></td> <td data-bbox="957 1545 1173 1601" style="text-align: center;">X</td> <td data-bbox="1173 1545 1386 1601"></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							



Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e kërkimore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale</p>	<p>Kontrolli i dijeve dhe përvetësimit të objektivave të programit dhe kompetencave profesionale të parashikuara bëhet nepërmjet</p>

<p>përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>harmonizimi të disa komponentëve si për shembull testimet e vazhdueshme me shkrim dhe me gojë, prezantimet e projekteve dhe detyrave të kursit, praktikave të përfshira në programin e kursit, frekuentimit dhe diskutimeve në auditor, por edhe provimeve me shkrim ose me gojë, etj. Të gjitha këto forma përcaktohen në rregulloren e programit të studimeve ku përfshihen edhe mënyra e kontrollit të dijeve në për lëndët përkatëse. Studentët njoftohen mbi këtë rregullore gjatë javës së (parë të fillimit të studimeve) orientimit, si dhe nga secili pedagog në auditor për lëndët përkatëse. Rregullorja dhe afatet e përcaktuara në kalendarin akademik bëhen publike dhe mund të konsultohen online. Për përgatitjen e diplomës si detyrim përmbyllës i programit të studimit vihet në dispozicion të studentëve edhe Udhëzuesi përkatës i përgatitur nga institucioni</p> <p><i>(Ref. E.9 Udhëzuesi për Mikrotezën dhe Diplomimin e Studentit në ISE, E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë")</i>.</p>			
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në fillim të lëndës në çdo semester, titullari i lëndës i njëj studentët me silabusin e lëndës, në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar emërimi dhe kreditet e lëndës, pedagogu i lëndës, vit/semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin e studentit, ngarkesa e orëve në auditor dhe jashtë tij, literatura e detyruar, si edhe mënyra e kontrollit dhe format e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Në vazhdimësi, njoftimet e detajuara për detyrat dhe provimet në kuadër të lëndës vendosen edhe në platformën LMS, si dhe u njoftohen me e-mail nga koordinatori e departamentit.</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë")</i>.</p>			
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara</p>	<p>Në ISE bëhet një vlerësim i vazhdueshëm i njohurive në të gjitha lëndët, duke analizuar performancën e studentit në mënyrë të drejtpërdrejtë, dhe në funksion të arritjes së objektivave të programit.</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 21).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.6 Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet nëpërmjet një</p>

<p>profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>kontrolli të vazhdueshëm të shprehura si përqindje (0-100%) e notës përfundimtare. Niveli i të nxënit vlerësohet përmes detyrave me shkrim dhe /ose me gojë duke përfshirë angazhimin në diskutime, për ese të përgatitura gjatë seancave mësimore (10% e vlerësimit), detyrat e kursit si dhe provimit të ndërmjetëm (20% e vlerësimit) dhe atij përfundimtar (60% e vlerësimit). Në varësi të lëndëve testimet gjat vitit variojnë nga 10-20% të vlerësimit përfundimtar.</p> <p><i>(Ref. E.12 Syllabuset e lëndëve: Tabela 15; Takim me studentët).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në vlerësimin e njohurive të lëndës do të përdoren së shpejti sisteme elektronike për kontrollin e provimeve. Ndërkohë, që institucioni përdor edhe sistemin e sekretimit/mbyllur për të garantuar objektivitetin e vlerësimit dhe rritur transparencën. Mbrojtja e Temës së Diplomës është një provim publik para një bordi provimi të përbërë nga të paktën dy pedagogë të lëndës (një prej të cilëve njëri është personel akademik me kohë të plotë).</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 25; Takim me pëdgaogët e programit, Ref. E.26 Rregullore e Zhvillimit të provimeve online për vitin akademik 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi përfundimtar i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e posaçme me së paku 2 anëtarë, të ngritura nga njësitë përgjegjëse, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Për vlerësimin e provimeve nuk angazhohen anëtarë të tjerë përveç titullarit të lëndës, me përjashtim të rastit kur lenda ka edhe një asistent, pra vetëm në rastin kur lenda zhvillohet nga më shumë se një pedagog, atëherë pedagogët që e kanë zhvilluar lëndën përfshihen edhe në vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Tezat e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës, nënshkruhen nga përgjegjësi i departamentit dhe azhornohen rregullisht duke patur si qëllim që të vlerësojnë njohuritë e studentëve. Studentët merren në provim nga një komision i përcaktuar nga titullari i lëndës, i cili është përgjegjës dhe ndjek zhvillimin e provimit</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 23, E.6 Rregullore e UT).</i></p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe/ose kamera sigurie.</p>	<p>Provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare zhvillohen me procedurë sekretimi duke mbajtur të fshehtë emrin e studentit në fletën e provimit derisa pedagogu dorëzon provimet e korigjuara në Sekretarinë Mësimore Çdo provim monitorohet nga dy pedagogë, sipas grafikut të miratuar nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p><i>(Ref. E.6 Rregullore e UT)</i></p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Rregulloret e UT parashikojnë vlerësim të detajuar për çdo pyetje dhe sqarime dhe argumentime për vlerësimin e marrë nga studenti për çdo detyrim të lëndës. Gjithashtu, vlerësimi i studentëve ka natyrë stimuluese dhe duhet të tregojë se çfarë di studenti dhe çfarë duhet të mësojë më shumë. Për këtë arsye vlerësimi i pedagogut mund të shoqërohet me konslutime.</p>

<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe stafi akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p><i>(Ref. Rregullorja e UT Neni 51)</i></p> <p>Gjatë zhvillimi të provimeve, ambjenti monitorohet nga dy pedagogë të caktuar nga Departamenti, ndërsa kopjimi ndëshkohet me marrjen e notës 4 (katër) si notë përfundimtare, pavarësisht vlerës së elementeve të tjera vlerësuese. Plagjiatura, tentativat për mashtrim apo cënim të rregullave gjatë procesit akademik sqarohen edhe në Udhëzuesin për Mikrotezen. Sistemi për plagjiaturën po përfundon në këtë periudhë duke mbledhur më parë nga pedagogët nevojat e tyre.</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 23, Ref. E.9 Udhëzuesi për Mikrotezën dhe diplomimin e studentit në ISE).</i></p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Vlerësimi i dijeve dhe njohurive të fituara nga studentët e këtij programi bëhet në zbatim të Rregullores së Përgjithshme të UT dhe asaj të ISE. Pedagogu vlerëson me pikë secilin komponent të tezës. Rezultatet e vlerësimeve të provimeve bëhen në përfundim të provimit për provimet me gojë brenda 15 ditëve nga data e zhvillimit të tyre për ato me shkrim. Pas korrigjimit provimet dorëzohen brenda 5 ditëve në sekretarinë mësimore së bashku me procesverbalet përkatëse. Notat i jepen studentit nga sekretaria mësimore ose nëpërmjet aksesit online. Vlerësimi për komponentët e tjerë i dorëzohet studentit përpara zhvillimit të provimit përfundimtar, dhe pedagogu nuk ka të drejtë të ndërhyjë për ndryshimin e tyre pas zbardhjes së rezultateve të provimeve</p> <p><i>(Ref. E.6 Rregullore e UT, Ref. E.26 Rregullore e Zhvillimit të Provimeve online viti akademik 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Studenti ka të drejtë që të ankohet për rregullat e zhvillimit të provimit brenda 24-orëve nga data e provimit dhe ankesa i paraqitet me shkrim përgjigjesit të departamentit, i cili nëse verifikon shkelje të korrigjueshme ndërmerr hapat e nevojshëm së bashku me komisionin e provimit. Në rast se shkeljet nuk janë të korrigjueshme atëherë vendimi i përcillet dekanit që nëse e shikon me vend merr vendim për anulimin e provimit dhe ri-zhfillimin e tij.</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e UT neni 50-51).</i></p>
<p>Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet</p>	<p>Në rast se studenti nuk është i bindur për vlerësimin korrekt nga ana e pedagogut, atëherë ankohet brenda 48 orësh me shkrim pranë Përgjegjësit të Departamentit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e problemit e përcjell tek dekanin. Dekanin ngre brenda 48 oreve nga marrja në dijeni për ankesën ngre një komision ad-hoc për verifikimin e pretendimeve të studentit dhe përcakton vlerësimin përfundimtar. Vlerësimi i Komisionit që ngrihet është përfundimtar dhe mund të jetë i njëjtë, më i lartë ose më i ulët se vlerësimi i kontestuar. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore, dhe arkivohen në zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm.</p>

	<i>(Ref. E.7 Rregullore e UT neni 50-51).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7	
Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Ky program studimi synon që të pajisë studentin me njohuritë e nevojshme si në profilin akademik ashtu edhe profesional. Programi ofron njohuri të thelluara në politikat dhe qeverisjen e BE duke harmonizuar aspektin teorik me metodologji lëndë aplikative plotësojnë orientimin e moduleve të programit në fushën e ekspertizës së programit. Përpjekje në rritje po bëhen nga stafi akademik i punësuar në dy vitet e fundit mënyrë që mësimdhënia të harmonizohet me pajisjen e studentëve me njohuri për punën e pavarur kërkimore, si edhe në ndihmesën përr të promovuar botimin e arritjeve të tyre shkencore</p> <p><i>(Ref. Takim me Zyrën e Kurrikulave, dhe me Stafin Akademik, (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 4 dhe 9).</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Përveç larmishmërisë së moduleve, karakteri ndërkombëtar i programit të studimit ofron pjesmarrjen e ekspertëve vendas dhe të huaj, për të mundësuar në të ardhmen e afërt - edhe me ndihmën a projekteve Jean Monet të ISE - zhvillimin të disa lëndëve në gjuhën angleze, lëvizshmëri të studentëve falë projekteve të mobilitetit, cka të gjitha së bashku krijojnë një ambient multikulturor. Këto aktivitete, së bashku me fokusin e ISE në aftësitë e të menduarit kritik, teknologjitë e informacionit dhe punën në grup krijojnë mundësi për zhvillimin e aftësive të veçanta për komunikimin ndërkulturor, reflektimin individual si edhe për zgjerimin e perspektivës dhe analizës në fushën studimore dhe atë sociale të studentit.</p> <p><i>(Ref. E.11 Plani mësimor i programit të Studimit, (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 3 dhe 4).)</i></p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës.	<p>Si rregull, në përfundimit të lëndës pedagogu bën një përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, duke përfshirë në diskutim edhe studentët dhe duke marrë mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Gjithashtu eseja apo detyra e kursit që zhvillohen janë një formë e shqyrtimit të aftësive që kanë përfituar studentët nga lënda</p> <p><i>(Ref. Takimi me stafin akademik).</i></p>

<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Në përfundim të lëndës pedagogu rikthen në fokus për studentët çështjet apo konceptet më të rëndësishme të trajtuara si dhe jep orientimet e nevojshme për përgatitjen për provim. Kjo është një praktikë që zbatohet nga programi në javën e 15 të semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit</p> <p><i>(Ref. Takimi me stafin akademik).</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Stafi akademik zhvillon seminare dhe leksione të hapura jashtë orarit mësimor me lektorë apo ekspertë të ftuar me qëllim që të informojë kolegët dhe studentët e interesuar mbi zhvillimet më të fundit sipas fushave të tyre të studimit. Akordimi i tre projekteve Jean Monet për ISE do të ndihmojë më shumë në këtë aspekt.</p> <p><i>(Ref. E.14 Raport i Analizës Vjetore të ISE 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Mësimdhënia në këtë program studimi harmonizon njohuritë teorike me aspektin praktike, përmes projekteve tematike apo detyrave të kursit ku studentët mund të zbatojnë në praktikë njohuritë dhe aftësitë e marra. Praktika profesionale është një tjetër detyrim akademik i programit të studimit, e cila nën mbikqyret nga një pedagog i departamentit ndihmon në rritjen e aftësive profesionale dhe mundeësi më të mira për integrimin në tregun e punës.</p> <p><i>(Ref. Takimi me stafin akademik)</i></p>
<p>Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Përmes detyrave të kursit simulimit të situatave reale apo edhe diskutimet me ekspertë të jashtëm, stafi akademik inkurajon përfshirjen e studentëve në punën kërkimore shkencore, ndonëse nuk ka aktualisht një përfshirje të studentëve në kuadër të projekteve apo grupeve kërkimore të organizuara në nivel njësie bazë.</p> <p><i>(Ref. Takimi me stafin akademik dhe studentët)</i></p>
<p>Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>Për të nxitur një klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve novative, stafi akademik perpiqet të organizojë dhe mbështesë studentët në zbatimin e aktivitete specifike me pjesëmarrjen e aktorëve të jashtëm. Për shembull "Agora Studentore: Procesi i Integritimit Evropian dhe Identiteti" është një aktivitet ku studentët e programit paraqiten 6 referate shkencore, të cilat u integruan si pjesë e publikimit që ISE ka përgatitur për këtë tematikë</p> <p><i>(Ref. Publikime dhe Konferenca ise.edu.al).</i></p>
<p>Kriteri 9. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Programi synon vendosjen e kërkimit shkencor në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies e mësimnxënies nëpërmjet ngritjes së kualifikimit dhe ekspertizës së stafik akademik, por edhe transferimit të arritjeve bashkëkohore në fushën e shkencës tek studentët, nëpërmjet përfshirjes së tyre në veprimtari kërkimore, si rasti i aktivitetit "Laboratori i Debatit mbi Integrimin Evropian në</p>

	<p>auditorët universitarë” i cili kishte si qëllim zhvillimin e analizës kritike dhe zhvillimin e njohurive të studentëve mbi këtë temë të rëndësishme. Kostoja e publikimeve të studentëve si në këtë aktivitet ashtu edhe në atë të përmendur më lart janë mbuluar nga institucioni</p> <p><i>(Ref. Publikime dhe Konferenca ise.edu.al).</i></p>			
<p>Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve</p>	<p>Mobiliteti Ndërkombëtar mbetet një objektiv themelor si i UT ashtu edhe programit dhe mbështetet me mbi 100 marrëveshje bashkëpunimi që UT ka nënshkruar me IAL të tjera, në ndihmë të projekteve specifike. Ndërkombëtarizimi është pjesë integrale e këtij programi studimi. Programet e mobiliteteve zhvillohen me pjesëmarrjen e studentëve dhe pedagogëve si për shembull +KA107 apo programe mobiliteti për studentët. Kështu në vitin akademik 2020-21, 2 studentë të ISE ishin pjesë e programit të mobilitetit Erasmus+, ndërsa 10 studentë kanë qenë e mobilitetit nga programe të ndryshme bashkëpunimi. Megjithatë ende nuk ka programe të double apo join degree me programe të tjera, të cilat do të krijojnë një hapësirë më të gjerë të formimit profesional si për studentët ashtu edhe për pedagogët.</p> <p><i>(Ref. https://unitr.edu.el/marreveshjet-bilaterale-2/. Ref. E.28 Vlerësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucionet brenda dhe/ose jashtë vendit)</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.8	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës, para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Programi i studimit përfundon me Mbrojtjen e Temës së Diplomës një provim publik përpara një komisioni, i cili përbëhet nga dy pedagogë dhe ngrihet për këtë qëllim. Studentët duhet të kenë përfunduar me sukses të gjitha lëndët e kërkuara dhe dorëzimin e tezës në mënyrë që të kualifikohen për mbrojtjen e temës. Teza është një projekt studimor individual i studentit në fushat e specializimit të tij</p> <p><i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 25).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e</p>	<p>Studenti udhëhiqet gjatë periudhës së përgatitjes së tezës nga pedagogë me ekspertizë në fushën e specializimit. Për përgatitjen e tezës studentit i ofrohet edhe një ndihmë e specializuar nëpërmjet një udhëzuesi, i cili ofron të gjithë informacionin e nevojshëm në</p>

<p>nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>lidhje me procedurat dhe hapat që duhen ndjekur nga studentët për zhvillimin e tezës. Studenti asistohet edhe përmes takimeve të tjera me pedagogun udhëheqës dhe komunikimit përmes e-mailit dhe platformave të tjera LMS, që janë në dispozicion të studentit dhe pedagogut udhëheqës. (Ref. E.9 Udhëzuesi për Mikrotezën dhe Diplomimin e Studentit në ISE).</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë dy viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të tezës/diplomave.</p>	<p>Udhëheqësit e temave të diplomës janë personel akademik efektiv i UT i profilizuar në fushën përkatëse. Përzgjedhja e temave bëhet nga studentët në bazë të temave që paraqesin ata ose pedagogët e programit. Mentorimi i studentit bëhet nga udhëheqësi i tezës i miratur nga departamenti në bazë të dispozitave në fuqi. Kërkesa për të propozuar temat dhe mentorin bëhet pranë kordinatorit të programit i cili harmonizon kërkesat e studentëve me mundësitë reale pa çënuar cilësinë e punimeve të diplomave dhe duke evituar përsëritjet (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 25).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Në përgatitjen e temës së diplomës studentët ndihmohen nga stafi i programit për realizimin e detyrimeve akademike ose kërkimore, hedhjen e të dhënave grafike apo statistikore, përpunimin e pyetësorëve apo anketave duke përdorur të gjithë infrastrukturën e bibliotekave, sallave të kompjuterave por edhe duke shfrytëzuar bazën kërkimore apo arshivore të institucioneve të tjera me të cilat programi ka marrëveshje bashkëpunimi (Ref. E.28 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në fondet e bibliotekës; E.29 Vlerësimi i të bashkëpunimit me insitucionet brenda dhe jashtë vendit).</p>
<p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Udhëheqësi i temave të diplomës e mentoron studentin gjatë gjithë periudhës së përgatitjes së saj duke e orientuar studentin për përgatitjen e temës në zbatim të udhëzuesve të miratuar dhe në përmbushje të standarteve akademike. Punimi i diplomës duhet të respektojë kërkesat e formatit dhe rregullat e etikës akademike. Në përfundim, udhëheqësi i temës nënshkruan temën e diplomës që do të mbrohet përpara komisionit te ISE (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 25 paragrafi 3 dhe 7).</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me</p>	<p>Për vlerësimin (notën) e tezës së masterit vendos komisioni i ngritur për këtë qëllim. Sezonet e rregullta të mbrojtjes së diplomës janë ato të verës, vjeshtës dhe dimrit ndërsa sezone specifike mund</p>

notë.	të përcaktohen me urdhër të drejtorit të ISE. Anëtarët e komisionit bien dakord për notën dhe në rast se kjo nuk arrihet vendoset mesatarja e notave të propozuara nga të dy anëtarët (Ref. Takimi me stafin akademik, (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 25 paragrafi 8-9).			
Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Në përfundim të përmbushjes së të gjitha detyrimeve akademike, studenti pajiset me diplomën Master i Shkencave në "Politika dhe Qeverisje ne Evropë" dhe suplementin e saj, sipas formatit të miratur nga MASR dhe i firmosur nga Drejtori i ISE dhe Rektori i UT (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 25 paragrafi 1-2, 10; E7/1 Fromati i Diplomës dhe Suplementi i saj).			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të programit, me kërkesën e tij, studentit i vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar (Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 25 paragrafi 1-2, 10; E7/1 Fromati i Diplomës dhe Suplementi i saj).			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen	Pas përfundimit të studimeve, kopje e dokumentacionit të studentit të regjistruar arkivohet dhe ruhet për një periudhë pa afat. Në përmbushje me detyrimet institucionale, informacioni i paraqitet palëve të interesuara në përputhje me normativat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale. Institucioni disponon një databazë të plotë të të dhënave të studentëve, dhe përpunon të dhëna statistikore sipas kërkesave të institucioneve përgjegjëse apo nevojave të vetë institucionit (Ref. Takim me Degën e Burimeve Njerëzore).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA,
LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sektori i Burimeve Njerëzore, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme të rekoratit të UT, mban dhe administron të dhënat e stafit akademik (PAE dhe PAK) ashtu edhe atij ndihmës. Kjo strukturë anagazhohet edhe në përditësimin e të dhënave, si pjesë e dosjes personale të stafit akademik ndërsa kopje të dokumentacionit lidhur me stafin e rekrutuar dhe angazhimin e tij në mësimdhënie dhe kërkimin shkencor mbahen në ISE. Të dhënat e personelit mblidhen, ruhen dhe përditësohen në dosjen individuale të stafit, që GVJ kishte mundësi për të parë gjatë vizitës në institucion. Zyra e Burimeve Njerëzore mban evidencë edhe për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër.</p> <p><i>(Ref. Statuti i UT, Kre V, seksioni I; E. 10 Format i Dosjes personale të stafit akademik; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore.)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Institucioni ka një procedurë të mirëpërcaktuar e cila dikton politikat dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik në Manualin e Punësimit të Personelit. Sipas nevojave të ISE dhe në bashkëpunim me rektoratin publikohen vendet vakante dhe kriteret e punësimit për secilin vend vakant, të cilat më pas i percillen APP për njoftimin publik. Procedura e rekrutimit është në përshtatje me aktet ligjore në fuqi dhe me rregulloret përkatëse të UT. Një komision i vecantë ngrihet për të shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve dhe zhvilluar intervistën. Procedura e rekrutimit ndiqet nga Zyra e Burimeve Njerëzore e institucionit.</p> <p>Procedura e rekrutimit të personelit është përcaktuar në Manualin e Punësimit të Stafit në UT ndërsa personeli akademik gëzon status dhe trajtim specifik në përputhje me VKM nr. 329 date 12.4.2017, "Per statusin dhe trajtimin e personelit akademik</p> <p><i>(Ref. E.19 Manual i Punësimit të Personelit në UT, Rregullore e UT neni 25; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore, E.2 Statuti i UT nenet 65, 67-72; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të</p>	<p>Sikundër shpjeguar më lart, kriteret për vendet vakante shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Procedura nis me evidentimin e nevojave nga njësia bazë, në varësi të nevojave dhe kualifikimeve të nevojshme për</p>



<p>kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit</p>	<p>pozicionin vakant, si edhe përcaktimin e kategorisë së personelit që nevojitet, që hartohet nga drejtuesi i njësisë dhe miratohen nga rektori. Më pas bëhet publikimi i këtij pozicioni bëhet nëprmet APP në faqen e internetit dhe testimi i kandidatëve, përzgjedhja e të cilëve kalon në dy faza: 1) shqyrtimi i dokumentacionit; 2) dhe intervistimi i kandidatëve të përzgjedhur nga një komision i posaçëm. Përzgjedhja e personelit bëhet duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm sikurse dhe ekspertizat dhe ngarkesën mësimore. Të njëjtat kritere ndiqen si në punësimin e stafit me kohë të plotë ashtu edhe atij me kohë të pjesshme.</p> <p><i>(Ref. RVB, fq. 50; E.26 Rregullore e UT neni 25-26; Takimi me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësi të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Mjediset e vendosura në dispozicion të stafit konsistojnë në një open-space me nje sipërfaqe prej 123m2 në të cilën përfshihen edhe zyra dekanit, një sallë mbledhjesh, sekretaria mësimore dhe departamenteve. Po ashtu ISE shfrytëzon edhe mjediset dhe sallat e godinës Liria si pjesë e infrastrukturë së UT. Ambjentet e punës janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e detyrave nga ana e stafit akademik. Konstatohet se IAL ka mjedise me kushte funksionale dhe të përshtatshme.</p> <p><i>(Ref. E.23 Infratsruktura akademike; vizita në institucion).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Sikundër e përmendur edhe në seksione të tjera të raportit, UT realizon disa insentiva të cilat angazhojnë dhe nxisin stafin për zhvillim akademik, duke stimuluar karrirën akademike në varësi të rezultateve të arritura në pjesmarrjen e konferencave apo në kërkimin shkencor. Stafi përfshihet në organizimin dhe realizimin e konferencave shkencore, projekteve kërkimore, mobilitete si dhe përmes skemës së financimit të kërkimit shkencor me anë të “UT – kërkim, ekselencë dhe inovacion” i cili është vënë në dispozicion për botime të artikujve shkencorë si edhe për të marrë pjesë ne aktivitete akademike apo aktivitete trajnuese dhe zhvilluese të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit. Personeli akademik i ISE ka arritur që të fitojë edhe tre projekte Jean Monet, një prej të cilëve i dedikohet aktiviteteve të mëtejshme kualifikuese të stafit. Përfitimi i të tre projekteve në vitin 2022</p>



	<p>dhe në një numër të konsiderueshëm projektesh ndërkombëtare apo edhe aktiviteteve si pjesë e rreth 100 Marrëveshjeve të Bashkëpunimit është një tregues i rëndësishëm në kuadër të zhvillimit të vazhdueshëm të stafit</p> <p><i>(Ref. E.32 Udhëzues për projektet e Kërkimit në UT; E.33 Udhëzues mbi Grantin për Konferenca dhe Punim Shkencor; Takimi me stafin akademik, Takimi me stafin akademik dhe me Zyrën e Projekteve).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimit-shkencor.</p>	<p>Projektet dhe bashkëpunimet e sipërpërmendura synojnë që stafi akademik të përfitojë nga eksperiencia dhe shkëmbimi i metodave inovative të mësimdhënies falë përfshirjes në projekte kërkimore me partnerë ndërkombëtarë, programet Erasmus etj. Institucioni organizon aktivitete dhe mbështet anëtarët e stafit për të ndërmarrë metoda inovative të mësimdhënies dhe përdorimit të teknologjive të reja si për shembull trainime në lidhje me mësimore platformat online apo edhe krijimin e Qendrës Virtuale të Zhvillimit Profesional dhe Trajnimit në UT, si edhe mbështet stafin në kërkim shkencor nëpërmjet informacioneve me aplikime për projekte të reja, mbështetje me fondin për botime të artikujve shkencor të dhe pjesëmarrjes në konferenca ndërkombëtare. Anëtarët e stafit janë aktiv në kërkim shkencor nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca dhe botimeve të artikujve shkencorë.</p> <p><i>(Ref. RVB, fq. 52; E.32 Udhëzues për projektet e kërkimit në UT; E.23 Infrastruktura e Akademikut; Takimi me stafin akademik).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programit të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Në informacionin e paraqitur lidhur me personelin e programit vihet re se stafi me titujt më të lartë akademik si profesor apo profesor i asociuar ka një ngarkesë të përgjithshme mësimore të lartë duke kaluar 400 orët në një vit akademik, por gjithmonë duke respektuar udhëzimin 29, për ngarkesën mësimore. Ndërsa pjesa tjetër e pedagogëve ka një ngarkesë më të pranueshme, ndonëse me përjashtim të një pedagogu, të tjerët kalojnë një normë mësimore me mbi 300 orë. Një sasi e lartë orësh mësimore, mund të ndikojë negativisht si në cilësinë e mësimit ashtu edhe në angazhimin e pedagogëve në kërkimin shkencor. Mendohet se numri i vogël i studentëve në këtë program studimi si edhe rritja e numrit të pedagogëve në program në tre vitet e fundit do të jetë një hap pozitiv në këtë drejtim. Harmonizimi i angazhimit të disa pedagogëve si në procesin e mësimdhënies ashtu edhe në aktivitete ndihmëse mund të ndihmojë jo vetëm në drejtim të optimizimit të burimeve por edhe për një koordinim më të mirë të këtyre hallkave, por duke mbajtur parasysh që kjo të mos sjellë një mbi-ngarkesë, e cila mund të prekë cilësinë e punës</p> <p><i>(Ref. Takimet me GVB dhe me stafin akademik).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik e kërkimor, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Pozicioni i ISE në brendësi të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë mundëson një godinë lehtësisht të aksesueshme për studentët por edhe një përfaqje më të mirë të infrastrukturës ndihmëse që ofron ky fakultet, si biblioteka dhe hapësira të tjera ndihmëse. Studentët e ISE kanë 4 salla leksionesh me një kapacitet prej 120 vendesh. Duke patur parasysh që numri i studentëve në të dy vitet në programin e studimit të paraqitur për akreditim është 20 studentë atëherë infrastruktura fizike e vënë në dispozicion është e mjaftueshme për të realizuar nga ana didaktike dhe logjistike përmbushjen e realizimit të pjesët teorike të programit të studimit. <i>(Ref. RVB, fq. 54; E.23 Infrastruktura akademike; Takimi me studentet e programit; Vizita në institucion).</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e ofruara nga institucioni janë të përshtatshme dhe të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e e procesit mësimor. Auditorët janë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektor, internet dhe foni. Përdorimi nga ana e studentëve dhe stafit akademik të sistemit LMS mundëson përdorimin e metodologjive e teknologjive bashkëkohore të aksesueshme në çdo kohë për materialet e hedhura nga pedogogu, leksione, materiale shtesë audio vizive etj. Përveç kompjuterëve të gjendur në klasat studimore, ka pajisje kompjuterike edhe në bibliotekë. <i>(Ref. RVB, fq. 54; Vizita në institucion; Takimet me stafin akademik dhe studentët).</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Në bazë të marrëveshjes me Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, ISE ka mundësinë e shfrytëzimit të infrastrukturës së bibliotekës së këtij fakulteti, si përsa i takon aksesit të fondit ashtu edhe hapësirës fizike, dhe laboratorëve didaktikë të saj të saj. <i>(Ref. E.29 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë; E.30 Rregullore e Bibliotekës; Vizita në institucion).</i>
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	N/A
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në	Falë projekteve ku merr pjesë por edhe bashkpeunimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kapacitetet e ISE me mbështetjen

bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	edhe të UT kur është e nevojshme, si rastet e marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera, mundësojnë mjedise të përshtatshme për realizimin e veprimtarive praktike dhe aktiviteteve të tjera. ISE garanton infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e veprimtarive praktike në institucion si për shembull leksione të hapura, seminare, tavolina të rrumbullakta, apo ëorkshope sikurse dhe bashkëpunon me institucione dhe organizata të tjera në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve. (Ref. RVB, fq. 55; E.23 Infrastruktura akademike).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	ISE shfrytëzon për aktivitetin e saj bibliotekën e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë si për punën kërkimore ashtu edhe për studimin. Biblioteka ka një numër prej 25 vendesh dhe një infrastrukturë që ofron akses si në materialin fizik ashtu edhe në atë online. Në kuadër të kësaj marrëveshje, biblioteka po e rrit numrin e titujve të dedikuar studimeve evropiane. Ajo që vlen të theksojmë është se studentëte ISE mund të përdorin dhe kanë akses edhe në bibliotekat e tjera të UT, duke qënë një njësi ndërfaqultetore. (Ref. E.29 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë; Vizita në institucionin).
Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Literatura te Biblioteka ofron akses me botime në shqip (65% e fondit), anglisht dhe gjuhë të tjera (35% e fondit). Biblioteka ka infrastrukturë për aksesimin e titujve të librave në bibliotekat online si për shembull JSTOR e cila në fushën e studimeve evropiane ofron një fond me rreth 7745 e-books 25.000 raporte dhe studime kërkimore, si edhe mbi 6700 teza disertacioni të publikuara në 21 vitet e fundit. Po kështu studentëve i ofrohet akses edhe në bibliotekën digitale COBISS+. (Ref. RVB, fq. 56; E.23 Infrastruktura akademike; https://unitir.edu.al/biblioteka-online ; Vizita në institucion).
Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	Regjistrimi dhe përdorimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në bibliotekë, përfshirë bibliotekat on-line, është pa pagesë (Ref. RVB, fq. 56; Vizita në insitucion).
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e	Biblioteka shërben edhe si sallë interneti dhe në ambjentin e

<p>pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>biblotekës ndodhen kompjutera që janë në dispozicion të studentëve. Kjo infrastrukturë dixhitale fizike ofrohet pa kufizime apo pagesë për të gjithë studentët e programit, në përputhje me rregulloren a bibliotekës. Megjithatë duhet të shihet me përparësi rritja e kapacitetit të vendeve në bibliotekë pasi numri i vendeve për një sallë studimi është i limituar, duke menduar që numri i studentëve mund të rritet.</p> <p><i>(Ref. E.30 Rregullore e bibliotekës; Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë; Vizita në institucion).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas marrëveshjes së lidhur midis ISE dhe FHF, të dyja institucionet do të kontribuojnë në shtimin e fondit të bibliotekës me tematika të studimeve evropiane, sipas kërkesave të studentëve dhe stafit akademik. Kërkesat për pasurimin e fondit të bibliotekës vijnë nga pedagogët dhe studentët e ISE. Nga takimi me stafin akademik na u konfirmua fakti që institucioni merr në konsideratë kërkesat e tyre për literaturë plotësuese.</p> <p><i>(Ref. E.29 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë; Takimi me stafin akademik).</i></p>			
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Biblioteka qëndron e hapur nga e hëna në të premte në orarin 08:00-16:00. Oraret e shërbimit të bibliotekës janë afishuar në hyrje të bibliotekës. Secili student dhe anëtar i stafit akademik ka një kartelë rregjistrimi dhe shërbehet nga një punonjëse e bibliotekës.</p> <p><i>(Ref. E.29 Marrëveshje ISE-FHF për aksesin në bibliotekë; Vizita në institucion).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UT/ISE ka një sistem të menaxhimit të informacionit që realizon ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të dhënave të studentit nga regjistrimi deri në diplomim. Ky sistem shërben edhe për nxjerrjen e statistikave dhe zhvillimin e analizave përkatëse. Sekretaria mban në formë të shkruar/hard copy: Rregjistrin themeltar të studentëve dhe Rregjistrin e arritjeve akademike të studentit. Këto të dhëna ruhen dhe arkivohen sipas legjislacionit përkatës mbi arkivat.</p> <p><i>(Ref. RVB, fq. 57; Takimet me antarët e GVB, stafin e sekretarisë)</i></p>

	<i>dhe me stafin akademik;).</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Sistemi i administrimit të brendshëm të informacionit dhe dokumentacionit funksionon edhe në lidhje me stafin akademik. Ky informacion menaxhohet nga struktura të ndryshme si: Dega e Burimeve Njerëzore, Protokoll/Arkiva, Sekretaria dhe IT në përputhje me rregulloren a brendshme të punës për funksionimin e administrates së rektoratit të UT. Të dhënat e stafit akademik ruhen dhe përditësohen një herë në vit. Për secilin anëtar të stafit akademik të angazhuar në programe studimi mbahet nga ISE informacioni lidhur me performancën akademike, por edhe lëndët përkatëse në secilin semestër, lëndët që mbulojnë, etj. <i>(Ref. E.10 Formati i dosjes personale të stafit; Takim me Degën e Burimeve Njerëzore).</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi i menaxhimit që përdoret mundëson aksesin e dedikuar për stafin dhe studentet sipas programeve të studimit duke respektuar mbrojtjen e të dhënave personale. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues, student apo pedagog. <i>(Ref. E.8 Rregulla të sekretarisë mësimore; Takimi me anëtarët e GVB).</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Sistemi i menaxhimit siguron aksesin nëpërmjet llogarive personale të stafit dhe studentëve në domain @unitir.edu.al. Secili student ka tashmë në dispozicion portalin e tij elektronik me akses personal nëpërmjet të cilit mund të arrijë të regjistrohet në programet e studimit, ti frekuentojë ato dhe të verifikojë arritjet e tij personale në mënyre konfidenciale. Institucioni mundëson dokumentacionin dhe komunikimin midis studentëve dhe stafit nëpërmjet këtij sistemi të menaxhimit. Këto sisteme lehtësojnë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit <i>(Ref. E.8 Rregulla të sekretarisë mësimore; takimi me sekretarinë mësimore).</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Përmes përdormimit në nivel institucional të sistemit platformës dixhitale të menaxhimit Teams të llogarive personale të stafit garantohe komunikimi në kohë reale midis studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Ky sistem realizon së fundmi edhe monitorimin në kohë reale i aktivitetit akademik. Sistemi është një mjet në dispozicion të analizave dhe raporteve që hartohen për organet drejtuese dhe titullarët, për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik. <i>(Ref. E.14 Raporti i Analizës Vjetore të ISE).</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	Në faqen internetit të UT gjendet informacion në lidhje me programin e studimit dhe aktivitetet e ndryshme, jetëshkrimet e pedagogëve të njëjësive kryesore, legjislacioni përkatës, kopje të marrëveshjeve të nënshkruara nga njëjësia kryesore, të dhënat për projektet kërkimore etj. Faqja në internet e programit është në gjuhën shqipe, por ka edhe me informacion në anglisht, në lidhje

	me veprimtarinë e UT. Mospasja e një faqeje të plotë në anglisht, nuk ndihmon ndërkombëtarizimin e programit, sepse nuk mund të vizitohet nga studentë apo pedagogë të huaj, duke ndikuar në përpjekjet e stafit në këtë drejtim. (Ref. https://unitir.edu.al/programe-studimi/).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Buxheti financiar në nivelin institucional hartohet në muajin tetor të çdo viti. Për të siguruar transparencën financiare pasqyrohen të ardhurat dhe shpenzimet e UT dhe secilës njësi të tij. Buxheti i ISE i akordohet nga buxheti i UT dhe hartohet në bazë të nevojave të paraqitura dhe plan-buxhetit afatmesëm 3-vjecar. Kostoja e programit të studimit është 78760000 lekë. UT i paraqet MASR raportet vjetore të çdo viti akademik, duke informuar mbi aktivitetet e kryera, gjendjen financiare të institucionit si edhe parashikimin për angazhimin e personelit akademik, tarifën e shkollimit për vitin në vijim, gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për çdo program studimi, si edhe informacione të tjera në bazë të udhëzimeve të ministrit. Për këtë program studimi nuk kishte një raport financiar të ardhurave dhe kostove. (Ref. Statuti i UT, neni 147).
Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.	Struktura e programit financiar bëhet duke i ndarë të ardhurat sipas shpenzimeve të tyre. Këtu përfshihet edhe detajimi i kostove të parashikuara për stafin akademik, mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjisë mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e saj, përmirësimin e infrastrukturës së mjediseve, auditorëve leksioneve, sallave dhe seminarëve, etj. Megjithatë, plani financiar përmban vetëm kostot dhe jo një pasqyrë të përgjithshme të blinacit financiar të programit duke përfshirë edhe përfitimet e programit nga tarifën studentore apo të tretë. (Ref. E.108 Raporti financiar vjetor dhe Plani i financimit të programit të studimit).
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson	UT kryen auditim të përvitshëm të brendshëm, e cila është në varësi

<p>dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>të Bordit të Administrimit, dhe të jashtëm. Në auditimin e përvitshëm, UT vlerëson dokumentacionin, gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar. Raporti i auditimit përmban një pasqyrë të hollësishme referuar bilancit për të ardhurat dhe shpenzimet. Raportet e auditimit përmbajnë edhe të ardhurat për ardhurat dhe ndarjen e burimeve financiare, të paraqitura në mënyrë të detajuar në tabelat përkatëse.</p> <p>Bordi i administrimit është organi kolegjal vendimmarrës që mbikqyr dhe kontrollon veprimtaritë administrative dhe financiare të UT. UT ka të dokumentuar raportet financiare për secilin vit akademik proces ky që kryhet cdo vit në muajt mars-maj. Raporti miratohet nga Bordi i cili përcakton nëse është e nevojshme të bëhen ndërhyrje të mundshme në financimet eventuale të programeve të ndryshme.</p> <p><i>(Ref. E.2 Statuti i UT neni 54 dhe 55, Ref. RVB, fq. 61).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar; raportet janë të përvitshme institucionale. Dokumentacioni i paraqitur ofron vetëm një tabelë kostosh të programit por jo një analizë financiare të tij.</p> <p><i>(Ref. E.108 Raporti financiar vjetor dhe Plani i financimit të programit të studimit, Ref. RVB, fq. 50-51).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Për këtë program studimi nuk ka një raport specifik financiar; raportet janë të përvitshme institucionale. Dokumentacioni i paraqitur ofron vetëm një tabelë kostosh të programit por jo një analizë financiare të tij.</p> <p><i>(Ref. E.108 Raporti financiar vjetor dhe Plani i financimit të programit të studimit, Ref. RVB, fq. 50-51).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UT realizon pranime në përputhje me ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” bashkërenduar Statutin dhe me aktet e tjera nënligjore të nxjerra nga UT, të cilat lidhen me politikat studentore në hyrje dhe në dalje. Programi ka një kohëzgjatje prej dy vitesh akademike, në përfundim të të cilave, studenti duhet të grumbullojë 120 ECTS. Programi synon përzgjedhjen e studentëve me rezultate të larta, ndërsa kuotat dhe procedurat për pranimin në program bëhen publike cdo vit akademik. Në UT mund të vijnë edhe studentë që vijnë me transferim dhe kërkojnë njohjen e krediteve të mëparshme apo shtetas të huaj</p> <p>Nga të dhënat tabelore rezultojnë se në këtë program studimi në 3 vitet e fundit janë regjistruar:</p> <p>2019 -2020: 11 studentë 2020 – 2021: 5 studentë 2021 – 2022: 6 studentë</p> <p>Ajo që vihet re është se mesataria në hyrje e studentëve është e kënaqëshme, ajo luhet nga 7 në 7.9.</p> <p><i>(Ref. E.2 Statuti i UT Kreu VII; E.20 Kriteret dhe kuotat e pranimit në ISE).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Nga shyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezultojnë se politikat dhe procedurat e ndjekura përpara i takon pranimit dhe përfundimit të studimeve janë të njëjta për të gjithë studentët. Të njëjtat rregulla aplikohen për të gjithë dhe të vetmet raste përjashtimore janë studentët me nevoja të veçanta për të cilët mund të ketë rregullime të ndryshme në lidhje me formën e testimit</p> <p><i>(Ref. E.2 Statuti i UT, Kreu IX; E.6 rregullore e UT Kreu IV; E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 20).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë</p>	<p>Në faqen zyrtare online të programit janë të aksesueshme për publikun kriteret lidhur me: procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, progresit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme</p>

lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	(Ref. https://ise.edu.al/studenti/ ; https://unitir.edu.el/kriteret-e-pranimiit-kuotat-dhe-tarifaf-e-studimit).		
Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.	Përzgjedhja e kandidatëve bëhet në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi sikundër shpjegohet më lart, dhe përmes kriterëve të aplikimit të shpallura publikisht, ku përfshihet edhe dokumentacioni që kandidati duhet të paraqesë. ISE shpall listën dhe renditjen përkatëse të kandidatëve publikisht përpara fillimit të procesit mësimor. Ky vendim sikundër edhe të gjithë kriteret, si të përgjithshme edhe të veçanta është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare të UIT Numri i kandidatëve të pranuar bëhet në bazë të mundësive reale të njësisë dhe brenda legjislacionit në fuqi. (Ref. https://ise.edu.al/studenti/ ; https://unitir.edu.el/kriteret-e-pranimiit-kuotat-dhe-tarifaf-e-studimit).		
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni i arsimit të lartë udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	Secili departament propozon kuotat e pranimit brenda datës 10 Dhjetor e vitit paraardhës kalendarik për të gjitha programet e ofruara dhe këto kuota si edhe kriteret e pranimit që ka programi i studimit përfshihen në të gjitha forma e informimit/orientimit të zbatuara nga institucioni. (Ref. E.2 Statuti i UT neni 94; E. 20 Kuotat dhe kriteret e pranimit ISE; https://ise.edu.al/studenti/ ; https://unitir.edu.el/kriteret-e-pranimiit-kuotat-dhe-tarifaf-e-studimit).		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	UT vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit në tjetrin në fillim të vitit akademik, nërsa shfrytëzimi i platformave LMS, mundëson një informacion dhe njohjen e përparimeve akademike nga studentët në kohë reale. Krahas sekretarisë mësimore, koordinatori i programit mundëson gjithashtu dhënien e informacionit. Në javën e parë të vitit akademik organizohet “Java e Orientimit Studentët”, ku studentët informohen për rregullat e frekuentimit, kurset e detyrueshme, modulet karakterizuese, kurset integruese, kurset e detyrueshme me zgjedhje, praktikën dhe temën e diplomës sezonet e provimeve, si edhe me numrin e krediteve që marrin për çdo

	lëndë, semestrin qe duhet ta ndjekin dhe universitetin që e ofron. <i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë”</i> ; <i>website i ISE: www.ise.edu.al</i>).			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Institucioni ka një rregullore mbi transferimet, njohjen e krediteve dhe mobilitetin ku bazohet realizimi i procedurës dhe informimi i studentëve mbi këto procese <i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 19; E.6 rregullore e UT).</i>			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Rregullorja e programit të studimit dhe silabuset aksesohen online nga studentët, gjithashtu në fillim të çdo semestri ata informohen dhe nga stafi akademik (dhe titullari i lëndës) mbi procedurat e vlerësimit të dijeve si edhe mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit që parashikohen në Kurikulumin e programit të studimit. Ato janë edhe pjesë e silabuseve të lëndëve, të cilat i vihen në dispozicion dhe i shpjegohen studentëve që në fillim të procesit akademik, ndërsa mbi progresin e tyre akademik studentët mund të informohen dhe nga sekretaria mësimore dhe pedagogu i lëndes <i>(Ref. E.12 Syllabuset e lëndëve, Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 21-23).</i>			
Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	ISE ofron një udhëzues informativ mbi punimin e diplomës, ku përfshihen kërkesat dhe dhe formati e testimit, duke përfshirë edhe njohuritë mbi shkrimin akademik për ti dhënë mundësinë studentit për të paraqitur një punë kërkimore origjinale dhe hulumtuese që demonstroi kompetencën në fushën e studimit dhe njohuritë profesionale në këtë profil. Periudhat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në Kalendarin Akademik <i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 25/3; E.9 Udhëzuesi për Mikrotezën dhe Diplomimin e studentit në ISE).</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Institucioni ka disa forma për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit si: organizimi në fillim të vitit akademik “Javës së orientimit”, takime të ndryshme mbi programin, cilat janë të hapura për studentët e interesuar, materialet informuese, faqja zyrtare e programit e cila përditësohet rregullisht, etj. Studentëve u ofrohet edhe shërbimi i këshillimit i cili informon studentët mbi tematika të tilla si shkrimi i CV, leksionet e hapura, rregullat e etikes, etj.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Informimi i studentëve lidhur me programin mësimor, strukturën dhe përmbajtjen, kohëzgjatjen, lende/modulet që zhvillohen dhe syllabuset e tyre, së bashku me detyrimet semestrale dhe strukturën akademike të programit, i ofrohet studentëve, qe kur kontaktojnë për të shprehur interes rreth programit Edhe nga takimi me studenten u vu re se ato ishin të mirë informuar mbi afatin e përfundimit të studimeve si dhe organizimin e programit të tyre nëpërmjet informimit online ose përmes zyrës së kujdesit të studentit, stafit akademik etj. <i>(Ref. Takim me studentët e programit të studimit; www.ise.edu.al)</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm ku përfshihet struktura, përmbajtja e programit, lëndët që do të zhvillohen, mënyrat e frekuentimit dhe vlerësimit e praktikës mësimore, diplomin, etj, dhe u siguron akses dhe informacion në lidhje me të gjithë elementët e programit të studimit që ata ndjekin përmes platformës LMS dhe stafit akademik që realizon programin. Info për studentët ofrohet edhe online në faqen e internetit ku gjendet informacion në lidhje me programin e studimit <i>(Ref. Takim me studentët e programit të studimit; www.ise.edu.al)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Institucioni organizon orientime të studentëve në lidhje me mundësitë dhe orientimin në tregun të punës si dhe mundëson kontaktin e studentëve me alumni të punësuar. Gjithashtu studentët informohen mbi mundësitë e punësimit dhe u ofrohet mbështetje institucionale nëpërmjet letrave të rekomandimit, orientimeve specifike etj. <i>(Ref. Takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës; E.5 Plani i Zhvillimit të ISE 2021-2024, f.7).</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i përditësuar mbi programin e studimit në lidhje me aktivitete të ndryshme mësimore që organizohen nga UT apo ISE, procesin mësimor, kalendarin akademik, infrastruktrën e shërbimit për studentët, etj <i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë”; www.ise.edu.al).</i>
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Sistemi LMS mundëson me përmirësimet e bëra nga fillimi i këtij viti informacionin e nevojshëm edhe nëpërmjet Portalit të Studentit duke krijuar lehtësi në komunikimin me stafin akademik të angazhuar në program, aksesin e leksioneve në formatin elektronik dhe çdo informacion tjetër që lidhet me organizimin e

	programit mësimor <i>(Ref. https://ise.edu.al/portali-studenteve/logohu).</i>			
Kriteri 6. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin mësimor të studentëve	Sistemi i menaxhimit të ISE siguron një akses të veçantë për stafin dhe studentët në domain @unitir.edu.al. Secili student ka në dispozicion portalin e tij elektronik me akses personal ku mund të konsultojë të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe rekordet e studentit, që nga fillimi i studimeve deri në përfundim të programit e studimit, të cilat ruhen edhe në Sekretarinë mësimore <i>(Ref. E.8 Rregullat e Sekretarisë Mësimore; E.6 Rregullore e UT nenet 42, 68-70; https://ise.edu.al/portali-studenteve/logohu).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.	UT disponon statistika për numrin e studentëve të diplomuar në programet e studimit që ofron. Kështu në vitin 2020-2021 janë diplomuar 22 studentë në ISE, në një nivel diplomimi prej 88%.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimit.	Institucioni disponon statistika të vjetore për numrin e studenteve të regjistruar në këtë program studimi, numrin e të tërhequrve nga programi, transferimet e studentëve apo mospërfundimin me sukses të viti akademik në të cilën zhvillohet programi i studimit. <i>(Ref. RVB, fq. 68; Takim me Sekretarinë mësimore).</i>
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.	UT disponon statistikatat për çdo student së bashku me dosjen me të gjitha të dhënat që nga momenti i regjistrimit e deri pas diplomimit. Këto të dhëna shfrytëzohen edhe për përgatitjen e analizave në nivel njësie por edhe institucioni <i>(Ref. E. 14 Raport i Analizës Vjetore ISE 2020-2021; Takimi me Sekretarinë Mësimore).</i>
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga	Të dhënat e studentëve për programin e studimit menaxhohen nga databaze e sekretarisë (sistemi i brendshëm). Të dhënat e studentëve janë të pasqyruara në regjistrin themeltar, të dhënat e rezultateve akademike të studentit si edhe Regjistri i diplomave

personat e autorizuar.	ruhen në databaze përkatës dhe janë lehtësisht të aksesueshme si për pedagogët ashtu edhe për studentët nëpërmjet logimit në portalin e Universitetit <i>(Ref. E.8 Rregullat e Sekretarisë Mësimore; E. 6 Rregulore e UT).</i>		
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve	Raportet analitike janë vjetore dhe plotësohen sipas formatit të hartuar nga rektorati dhe miratuar nga MASR. Raportet përfshijnë analizat mbi veprimtarinë e ISE, Njësisë bazë, performancën e studentëve dhe stafit akademik, në mënyrë që të dalin qartë nevojat dhe hapat që duhen ndermarre <i>(Ref. E.14 Raport i Analizës Vjetore ISE 2020-2021; E. 15 Analiza e Tregut të Punës).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Sipas dispozitave rregullatore, UT garanton përfshirjen e studentëve në disa struktura si: Senati Akademik (Kryetari i Këshillit Studentor dhe dy student të tjerë përfaqësues të tre cikleve të studimit); Këshilli i studentëve/Këshillat e studentëve në nivel njësie kryesore; 1 student në Këshillin e Etikës; dhe 1 student në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Studentët gjithashtu angazhohen për të vlerësuar cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet anketimeve, fokus-grupeve, etj <i>(Ref. E.2 Statuti i UT; Takim me studentët e programit të studimit).</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Angazhimi i studentëve është konkrete pasi ata janë vendimmarrës në disa struktura të univerisitetit. Të dhënat e mbledhura nga vlerësimet e studentëve për cilësinë e mësimdhënies, bëhen pjesë e analizave institucionale, me qëllim marrjen përmirësimitin e problemeve të ngritura nga studentët. Rezultatet e analizave diskutohen në nivel të strukturave drejtuese. Rekomandohet të bëhen analiza periodike mbi përfshirjen e të studentëve në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik <i>(Takim me përfaqësues të KSBC-së).</i>
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programit të studimit, institucioni duhet të	Institucioni konsideron ngarkesën e studentëve, brenda dhe jashtë auditorit, ngarkesën e punës së stafit akademik, si edhe aktet ligjore

<p>mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>në fuqi, kur harton apo rishikon programin e studimit. Ky i fundit dëshmon një ndarje të balancuar ndërmjet semsetrave. Semestri fundit i dedikohet punimit të diplomës, në mënyrë që studentën të kenë kohën e nevojshme për t'iu përkushtuar punimit të diplomës.</p> <p><i>(Ref. E. 6 rregullore e UT, Kreu III; E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 19).</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Si pjesmarrës në organet kolegjiale dhe në përputhje me përcaktimet statutore (KPSC/NJSBC) studentët kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në hartimin e kurrikulave apo përmirësimin e programit të studimit si nëpërmjet përfshirjes në organet kolegjiale, ku bëjnë pjesë, ashtu edhe pjesmarrjes në fokus grupe, përgjigjen e pyetësorëve online dhe mbledhje të departamentit në formatin e hapur për studentët</p> <p><i>(Ref. RVB, fq. 69; Takim me studentë).</i></p>			
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës</p>	<p>Sikundër shpjeguar më lart, Rregullorja e Universitetit përcakton procedurat në rast ankese nga studenti si përsa i takon procedurës ashtu edhe vlerësimit të provimit. Ndërkohë, pedagogu i lëndës dhe sekretaria mësimore janë në dispozicion të studentit për informacione. Studenti ka të drejtë të njihet me pikët totale të vlerësimit në tezë dhe ankimin brenda 48 orësh.</p> <p><i>(Ref.E. 6 Rregullore e UT, 50-51, Ref. E.8 Rregulla të Sekretarisë Mësimore, Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH "Politika dhe Qeverisja në Evropë" neni 23).</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi V.6 Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit merr pjesë në aktivitetet kërkimore e shkencore dhe motivon pjesëmarrjen e studentëve dhe përfshirjen e tyre në studime e projekte.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Personeli akademik merr pjesë në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.</p>	<p>Stafi merr pjesë në aktivitete ose konferenca që nxisin kërkimin shkencor ndërsa institucioni i kushton një vëmendje të veçantë pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e analizës së performancës individuale të pedagogut dhe programit e institucionit</p> <p><i>(Ref. E.14 Raporti i Analizës Vjetore 2020-2021; Takim me stafin akademik).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni lidh marrëveshje partneriteti me institucionet e huaja të arsimit të lartë, institute, me qëllim realizimin</p>	<p>ISE ka marrëdhënie bashkëpunimi me një sërë institucioneve vendi dhe të huaja, akademike apo nga sfera publike ose shoqëria civile. Zyra e Projekteve dhe marrëdhëniet me jashtë përpiqet të</p>

e studimeve, projekteve dhe kërkimeve të përbashkëta.	<p>ndihmojë në vendosjen e kontakteve me Universitete të huaja, ndonëse për momentin bashkëpunimet institucionale janë të limituara dhe të përqendruara kryesisht në nivel projektesh.</p> <p><i>(Ref. E. 28 Vlerësimi i Marrëveshjeve të bashkëpunimit të ISE; Takim me Drejtorinë e Kërkimit Shkencor, Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë).</i></p>		
Kriteri 3. Personeli akademik motivon studentët të hartojnë, shkruajnë dhe publikojnë studime e punime shkencore.	<p>Personeli akademik përpiqet të motivojë studentët në kërkimin shkencor ndonëse bashkëpunimi i stafit akademik me studentët në këtë drejtim mbetet ende i pamjaftueshëm. Mund të fillohet një projekt hulumtues në fushën e studimit të integritit e pritshmërive nga BE që mund të kontribuojë në përfshirjen e studentëve në punime shkencore</p> <p><i>(Ref. RVB, fq. 70; Takim me GVB).</i></p>		
Kriteri 4. Institucioni mbështet publikimin në revista shkencore ndërkombëtare të punimeve kërkimore shkencore të personelit akademik të institucionit dhe studentëve.	<p>Institucioni inkurajon stafin akademik për publikimin në revista shkencore ndërkombëtare duke ofruar një program granti i cili financohet nga buxheti i UT për të financuar punën kërkimore apo pjesëmarrjen në konferenca shkencore ndërkombëtare si pjesë e objektivave të "Planit të Kërkimit Shkencor të UT: 2018-2022.</p> <p><i>(Ref. E.33 Udhëzues mbi Grantin për Konferenca apo punim shkencor).</i></p>		
Kriteri 5. Institucioni dhe personeli akademik motivojnë dhe mbështetin studentët të angazhohen në studime inovative dhe patentave.	N/A.		
Kriteri 6. Personeli akademik ofron asistencën e nevojshme për kryerjen e analizave, matjeve studimeve dhe përpunimit të rezultateve në kuadër të realizimit të diplomës	<p>Teza është një projekt kërkimor individual, për të cilën udhëheqësi ofron mbështetje të vazhdueshme akademike dhe konsulencën e nevojshme për një punim shkencor me vlerë. Kjo ndihmë përfshin burimet për literaturën, burimet analizat, propozimi i strukturës së tezës. Përveç kësaj, nëpërmjet seanceve metodologjike studenti ka asistencën e nevojshme në kuadër të realizimit të diplomës, nëpërmjet vërejtjeve për të përmirësuar punimin, si edhe merr informacionin në lidhje me respektimin e etikës në kërkimin shkencor dhe plagjaturës, ndonëse për këtë të fundit po përfundon procesi i hartimit dhe zbatimit të programit.</p> <p><i>(Ref. E.17 Paketa e Instrumentave të Cilësisë në UT, detyrat dhe përgjegjësitë e udhëheqësit).</i></p>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X

Standardi V.7**Mbështetja e institucionit të arsimit të lartë siguron vazhdimësi në studime të thelluara dhe kërkim shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ndjek një politikë bashkëpunimi me organizmat shkencorë, kombëtarë, me qëllim rritjen e aktiviteteve dhe mobilitetit të stafit dhe studentëve të programit të studimit.	UT është i fokusuar dhe i hapur ndaj bashkëpunimit kombëtar dhe ka zyra të dedikuara për këtë bashkëpunim që përqendrohet në fushën e mobilitetit, kërkimit shkencor dhe projekteve. Njëkohësisht, Institucioni ka lidhur marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm për të nxitur një marrëdhënie më të mirë ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe praktikës. Përveç programeve ndërkombëtare të mobilitetit si Erasmus+, UT bashkëpunon me institucione të tjera akademike në vend <i>(Ref. E.14 Raporti Vjetor i ISE; Takime me GVB, me stafin akademik dhe me studente).</i>
Kriteri 2. Implementimi i metodave të kërkimit nga personeli akademik dhe studentët siguron vijueshmëri dhe përgatitje të studentëve për ciklin e tretë të studimeve.	Përfundimi i programit ISE u mundëson studentëve vazhdimin e studimeve të ciklit të tretë/doktoratë duke iu përgjigjur kërkesave për më shume specialistë në fushën e integritit evropian si edhe për të siguruar rritjen e nivelit mësimor dhe kërkimor në këtë fushë <i>(Ref. E.7 Rregullore e Programit të Studimit MSH “Politika dhe Qeverisja në Evropë” neni 4, pika 4).</i>
Kriteri 3. Institucioni ndjek një politikë të përfshirjes së studiuesve të rinj në projekte kërkimore vendës dhe të huaj.	ISE synon krijimin e një gjenerate të re profesionistesh dhe kërkuesish dhe për këtë qëllim publikohen në faqen e UT mundësi aplikimi për projekte kërkimore, botime akademike apo pjesmarrje në konferenca ndërkombëtare. Prej vitit 2021 është aprovuar programi “UT-kërkim, ekselencë, inovacion”, i cili jep informacionin e nevojshëm për procedurat e aplikimeve në rradhët e stafit akademik të UT <i>(Ref. E. 32 Udhëzues për projektet e kërkimit në UT; Takim me GVB).</i>
Kriteri 4. Institucion ndjek një politikë integruese për kërkuesit shkencorë të huaj.	Përfshirja e profesorëve të huaj është bërë e mundur në kuadrin e programit Erasmus + që mundëson stafi akademik i huaj të kalojë një periudhë kohe si pjesë e mobilitetit të tyre në UT, si edhe nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe me institucione partnere për të rritur shkëmbimet akademike ndërkombëtare <i>(Ref. RVB, fq. 73; https://unitir.edu.al/marreveshjet-erasmus-kal-te-nenshkruara-nga-universiteti-i-tiranes/).</i>
Kriteri 5. Institucioni ndjek një politikë favorizuese për mobilitetin e studentëve që angazhohen në veprimtari e aktivitete ndërkombëtare.	Institucioni ndjek një politikë nxitëse për një bashkëpunim të qëndrueshëm me institucione vendase dhe të huaja në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si edhe në praktikat profesionale <i>(Ref. E.14 Raporti Vjetor i ISE 2021-21).</i>
Kriteri 6. Institucioni, për të rritur profilin ndërkombëtar, fton për	UT dhe ISE kanë organizuar konferenca shkencore, trainime, leksione të hapura me pjesmarrjen e ekspertëve të huaj dhe

veprimtari kërkimore dhe mësimdhënie, personel akademik dhe studentë të huaj, për periudha të ndryshme kohore	vendas, si edhe përfaqësues të institucioneve diplomatike <i>(Ref. E.14 Raporti Vjetor i ISE 2021-21).</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			X


Standardi V.8	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Informimi i studentit organizohet nga departamenti dhe njësitë apo strukturat përkatëse, ku përfshihen si informacionet që kanë të bëjnë me karakteristika e programit të studimit, mundësinë e punësimit pas diplomimit. Përmes departamentit, studentëve i ofrohet edhe këshillim/mentorim gjatë gjithë periudhës së studimeve <i>(Ref. RVB, fq. 74).</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Koordinatori dhe stafi tjetër akademik dhe ndihmës akademik ndihmon studentët që hasin veshitësi në përvetësimin e lëndëve dhe ndërmjetëson me pedagogët përkatës për ofrimin e konsultimeve. Informimi i studentëve bëhet edhe nga stafi administrativ siç janë sekretaria mësimore, financa, IT apo biblioteka. Kjo ndihmë fillon që nga informacioni paraprak për programin deri në diplomimin e studentit. <i>(Ref. Takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Programi në fillim të viti/semestrit dhe në vazhdim orienton dhe informon studentët në lidhje me aktivitetet mësimore, praktikën, mundësitë për internship, etj. Këshillimi i studentëve përfshin edhe asistencën për përgatitjen për ne tregun e punës si përsa i takon orientimit ashtu edhe plotësimin të dokumentave (CV). <i>(Ref. E.5 Plani i Zhvillimit të ISE 2021-2024, f.8-11); Takim me Degën e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës).</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Institucioni nëpërmjet zyrës Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Karrierës disponon të dhëna për alumni, si edhe kryen ndjekjen e studentëve pas diplomimit duke përpunuar statistika që nevojiten për të analizuar cilësinë dhe performancën e programit në tregun e punës. Raporti vjetor i ISE për periudhën 2020-2021, dëshmon se punësimi i studentëve të këtij programi është në masën 80%

	<i>(Ref. RVB, fq. 75).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE/ARTEVE

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Sipas nenit 13 të Rregullores së përgjithshme, sektori i sigurimit të cilësisë përfshihet në strukturën e administratës qendrore. UT ka një strukturë të posaçme në nivel rektorati për sigurimin e cilësisë bazuar mbi dokumentat strategjike, modalitetet dhe procedurën përmes të cilave realizohet sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm. Ky sistem drejtohet nga Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) në UT dhe njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. KPSSC ka si mision të punës garantimin e cilësisë së brendshme të UT dhe programeve që ofrohen prej tij, në përputhje me standardet kombëtare të cilësisë. <i>(Ref E.2 – Statuti i UT)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentë dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga IAL, rezulton se UT ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë. Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë (KPSSC) i cili është i krijuar dhe miratuar nga Senati Akademik dhe vepron në nivel institucioni dhe është struktura përgjegjëse për garantimin e standardeve të cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit. Kjo njësi ka rregulloren e funksionimit të saj, ku janë të përcaktuar qartë të gjitha detyrat dhe objektivat që ka kjo njësi. Vetë ISE në

	<p>Janar të vitit 2022 kishte ngritur zyrën e sigurimit të cilësisë, një strukturë që do të funksiononte dhe bashkërendonte punën me KPSSC në nivel Universiteti.</p> <p><i>(Ref. Takimi me KPSSC, E.16 –Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT, Neni 15).</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Nga takimi me KPSSC si edhe nga evidencat e vëna në dispozicion, Institucioni përdor strukturat brenda tij për realizimin e sigurimit të cilësisë. Institucioni gjithashtu i është nënshtruar akreditimit institucional dhe për herë të parë po i nënshtrohet akreditimit të programeve të studimit.</p> <p><i>(Ref. Takimi me përfaqësues të KPSSC)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programit të studimit që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit</p>	<p>Njësia kishte një agjendë dhe plan punë të mirë përcaktur, ku përfshiheshin realizimi i pyetësorëve të studenve, përpunimi i tyre dhe përcjellja e informacioneve deri në nivel rektorati. Rezultatet e marra nga monitorimi, analizat dhe raportet vihen në dispozicion të strukturave drejtuese të njësive bazë të cilat janë përgjegjëse për marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu edhe nga takimi me studentët na u konfirmua që kishin realizuar pyetësorë 2 herë në vit, përpara përfundimit të semestrit.</p> <p><i>(Ref. Takimi me përfaqësues të KPSSC, Takimi me studentët)</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Natë përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Në nivel institucional struktura përgjegjëse për monitorimin e cilësisë është KPSSC -ja. Në nivel njësie bazë është Departamenti i cili ofron programin e studimit së bashku me strukturat e tij të brendshme si koordinatorët e programeve i cili rishikon dhe vlerëson cilësinë e programit të studimit. Në nivel të njësisë bazë, të gjitha veprimtaritë e departamentit përfshihen në raportin vjetor të njësisë (<i>Evidenca 14</i>). Konstatohet se, programet e studimit, i nënshtrohen në mënyrë periodike monitorimit dhe vlerësimit nga sistemi i sigurimit të cilësisë, gjë që ndikon në përmirësimin e tyre.</p> <p><i>(Ref. Takimi me përfaqësues të KPSSC).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin,</p>	<p>Drejtimitet e vlerësimit janë të ndarë sipas zërave përkatës në rregulloren për sigurimin e cilësisë dhe përfshijnë vlerësimet e</p>

<p>miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programit të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>studentëve, vlerësimet e personelit akademik, formën individuale të vlerësimit të performancës së pedagogëve, formën e transparencës së notave, vlerësimin në raportet vjetore mbi procesin e të mësuarit dhe standardet përkatëse të cilësisë së departamentit në fund të vitit akademik. Kur është e nevojshme, rekomandohen masa për ndryshimin, rishikimin ose përmirësimin e elementeve të këtij programi. Për çdo ndryshim që ndërmerret propozimi dhe argumentimi bëhet nga departamenti dhe më pas përcillet në rektorat.</p> <p><i>(E.2 Statuti i universitetit, E.7 Rregullororia e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Në aktet rregullatore të sigurimit të cilësisë UT ka përcaktuar metodat dhe instrumentat e vlerësimit të cilësisë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimet e realizuara, GVJ konstaton se në tërësi këto mjete përdoren nga KPSSC në nivel qendror dhe KPSSC e njëjësive kryesore, me qëllim përgatitjen e raportit vjetor institucional, ku përfshihen informacione dhe vlerësime për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në institucion, cilësinë e shërbimeve të ofruar studentëve si dhe masat e rekomanduara në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Mekanizmat më të përdorur janë pyetësorët e studentëve, vetëvlerësimi nga ana e pedagogëve, etj.</p> <p><i>(E.16. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë, UT, E.17. KPSSC - Paketa e Instrumentave të Cilësisë, UT.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Në përfundim të procesit të vlerësimit, realizohet përpunimi i pyetësorëve. Në bazë të rezultateve të marra hartohet raporti i cili i përcillët autoriteteve drejtuese. Në raport mund të lihen rekomandime të cilat do të shërbejnë për përmirësimin e programit të studimit. Rekomandimet mund të lidhen për përmirësimin e kurrikulës së programit, në këtë rast bëhet propozimet përkatëse nga departamenti dhe i përcillën për miratim Senatit Akademik.</p> <p>Në rast se raporti hartohet në nivel institucional, KPSSC ia përcjell KPSSC në nivel të njëjësive bazë, kjo e fundit ia bën me dije departamenteve. Nga takimi me stafin akademik konstatoam se, gjatë mbledhjeve të departamentit, stafi merr djeni për rezultatet, por gjithmonë duke ruajtur parimin e konfidencialitetit.</p> <p>E gjithë procedura e mësipërme është e mirë strukturuar në rregulloren për sigurimin e cilësisë.</p> <p><i>(E.16. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë)</i></p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Në manualin për sigurimin e cilësisë janë përcaktuar elementet që duhet të përmbajë raporti vjetor i vlerësimit. Ai duhet të përmbajë dhe të dhëna nga raporti i vitit paraardhës dhe rezultatet që rrjedhin nga ai. Raporti përmbledh të dhëna të marra nga aktorë të ndryshëm, duhet të përqendrohet në përvojën e studentëve si dhe mënyrën e adresimit të çështjeve gjatë vitit akademik Në nivel departamenti, në raportin vjetor të departamentit, bëhet një përshkrim i rezultateve të vlerësimeve, por nuk është hartuar një plan veprimi për masat e</p>

	marra për adresimin e mangësive për vitin pasardhës akademik <i>(Evidenca 18).</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programit të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Programi i studimit vlerësohet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë në nivel njësie dhe departamenti. Në fund të vitit akademik mblidhen të dhënat sipas rregullores për sigurimin e cilësisë të cili përfshihen në raportin vjetor të departamentit, që vlerëson mësimdhënien, të nxënit dhe standarde të tjerë të cilësisë.</p> <p>Të dhënat NJSBC e departamentit i dërgon pranë NJSBC në nivel ISE, bashkë me rekomandimet. Më pas, brenda afateve të caktuar ato i përcillen NJSBC së UT. Rezultatet e performancës i dorëzohen Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë. Komisioni, më pas e përcjell në Senat, me qëllim marrjen e vendimeve në funksion të përmirësimeve të nevojshme</p> <p><i>(E.16. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Ev. shtesë A.4.1, Evidenca 14, E.2 Statuti UT).</i></p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>UT ka parashikuar në rregulloret e brendshme instrumentet që përdoren për kryerjen e vlerësimit. Në të njëjtat akte janë specifikuar dhe metodat për kryerjen e vlerësimit, indikatorët dhe burimet e informacionit për performancën e stafit akademik. Këto instrumente dhe metoda shërbejnë për hartimin e raportit vlerësues të programit të studimit dhe përmirësimit të tij</p> <p><i>(Ev. shtesë A.4.1, E.16. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë; Evidenca 17)).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor</p>	<p>Institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për sigurimin e cilësisë si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës, sylabuseve, rezultatet e të nxënit, testet, etj. Sipas RVB, UT përfshin të dhënat e raporteve semestrale si përqindjen e kalueshmërisë, notat mesatare apo realizimin e objektivave në raportin e vlerësimit të brendshëm për programin e studimit</p> <p>Gjithashtu, ISE shqyrton vlerësimet që bëhen në përmbyllje të praktikës mësimore, nëpërmjet formularëve që plotësohen për këtë</p>

gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	qëllim I gjithë informacioni i mbledhur përpunohet dhe analizohet në nivel njësie bazë dhe ISE. <i>(Ev. 14, Ev. , shtojca 2).</i>								
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program	Institucioni përdor metoda të tërthorta për sigurimin e cilësisë si: vlerësimet e drejtuesve; vlerësimet e ekspertëve, vlerësimet e studentëve; vlerësimet e të diplomuarve; vlerësimet e bashkëpunëtorëve; vlerësimet e punëdhënësve; të dhënat e mbledhura nëpërmjet anketimeve, intervistave, fokus grupeve, vëzhgimeve, rezultateve të provimeve, të diplomimit <i>(Ev. 16; Ev. 17; Evidenca shitesë).</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	UT, në aktet dhe procedurat e cilësisë, ka parashikuar aktorët që përfshihen në procesin e sigurimit të cilësisë si: njësitë bazë, stafi akademik, dhe studentët, të cilët japin kontributin gjatë realizimit të pyetësorëve dhe procesit të akreditimit institucional dhe të programeve. Gjithashtu, në aktet dhe procedurat e cilësisë është parashikuar dhe bashkëpunimi me ekspertë të jashtëm, sipas përcaktimeve statutore <i>(Evidenca 2)</i> dhe në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësive kryesore. <i>(Evidenca 2, Evidenca 16,</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me	UT ka përcaktuar detyrat që duhet të përmbushen nga personat e angazhuar në sistemin e brendshëm të cilësisë në njësi bazë dhe institucional. Detyrat dhe përgjegjësitë janë përmendur në nenet 140 e 141 të statutit, në kreun III të Rregullores për sigurimin e



<p>përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>cilësisë.</p> <p>Gjithësesi, GVJ vëren se ka ende hapësirë për detajimin e përgjegjësive dhe detyrave në aktet e brendshme të ISE dhe sidomos rregulloret e sigurimit të cilësisë. Një detajim i tillë do të sqarojë më mirë detyrat e secilit ndaj sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>(Evidenca 2, Evidenca 16)</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në përputhje me statutin e UT-së, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë janë 11 anëtarë, të cilët përfaqësojnë njësitë kryesore, strukturat e sigurimit të cilësisë në rektorat dhe studentët. Senati ka përgjegjësinë finale për miratimin, monitorimin dhe vlerësimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë.</p> <p>NJSBC e UT-së përbëhet nga 9 anëtarë, ku përfshihen personel akademik i secilit fakultet dhe ISE me kohë të plotë, 1 anëtar i jashtëm (ekspert) dhe një përfaqësues i Këshillit Studentor. Ndërsa NJSBC në nivel njësie kryesore ka në përbërje një anëtar nga stafi akademik me kohë të plotë i çdo njësie bazë, një anëtar personel ndihmësakademik dhe një student. Në nivel njësie bazë, NJSBC përbëhet nga 5 anëtarë, që përfshijnë tri përfaqësues nga personeli akademik me kohë të plotë, një personel ndihmësakademik dhe një student.</p> <p><i>GVJ vëren se në nivel njësie kryesore NJSBC nuk ka anëtar të jashtëm që përfshihet në proceset e vlerësimit të cilësisë. GVJ sugjeron që të përfshihet një i tillë.</i></p> <p><i>(Evidenca shitesë A.4.1, Evidenca 2, Evidenca 16, neni 13).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Vlerësimi i brendshëm i cilësisë bazohet në standardet profesionale dhe parimin e pavarësisë institucionale. Struktura, roli dhe përgjegjësitë e sistemit dhe organeve të sigurimit të cilësisë bazohen në kornizën ligjore dhe organizimin e brendshëm të institucionit</p> <p>Procesi në tërësi e respekton integritetin akademik dhe nuk krijon diskriminim apo pabarazi kundrejt personelit dhe studentëve. Ky konstatim u përforëua gjatë takimeve me stafin akademik dhe studentët.</p> <p><i>(Evidenca 2; Evidenca 16).</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Sipas për organizimin dhe funksionimin e NJSBC-ve të njësisive kryesore, një nga anëtarët e NJSBC, është ekspert i jashtëm në fushën e sigurimit të cilësisë, i caktuar me vendim të rektorit</p> <p>Vlerësimi i brendshëm bazohet ndër të tjera, dhe në vlerësimet e ekspertëve</p> <p><i>(Evidenca 16, neni 31/1, germa e, Evidenca shitesë A.4.1).</i></p> <p><i>Në këtë kuadër GVJ sugjeron që, në hartimin e raportit të</i></p>

	<i>vlerësimi, të angazhohet dhe një përfaqësues i jashtëm</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Organizimi dhe veprimtaritë që lidhen me sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë janë përfshirë në aktet e brendshme të UT. Ato janë transparente dhe mundësojnë akses jo vetëm nga studentët por dhe nga çdo palë e interesuar. Sipas rregullores për sigurimin e cilësisë në UT, informacioni i publikuar në lidhje me sigurimin e cilësisë duhet të përcillet me një gjuhë të kuptueshme. Raportet e vlerësimi të brendshëm e të jashtëm bëhen publike. UT dhe njësitë kryesore kanë përgjegjësinë për komunikimin dhe për publikimin e rezultateve të monitorimit, të vlerësimi dhe të akreditimit.</p> <p><i>Gjithësesi GVJ vëren se në faqen e ISE ky detyrim nuk është i përmbushur plotësisht prandaj sugjeron që të merren masa që në faqe e ISE të përmbushen të gjitha detyrimet që rrjedhin nga rregullorja për sigurimin e cilësisë.</i></p> <p><i>(Evidenca 2; Evidenca 16).</i></p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>GVJ vëren se publikimi i rezultateve të vlerësimi të programit të studimit bëhet në përputhje me ligjin dhe aktet e UT-së. Qëllimi i vlerësimi është paraqitja e të dhënave mbi programet e studimit dhe përmirësimi i tyre. Nga shqyrtimi i raporteve të publikuar në faqen e UT si dhe pyetësorët e ndryshëm, nuk rezulton që të jetë cenuar liria akademike apo të dhënat personale</p> <p><i>(E.17; Evidenca shitesë A.14).</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimi duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	<p>UT i përdor të dhënat e përftuara nga metodat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta në funksion të rritjes së cilësisë së programit të studimit. Këto të dhëna përdoren gjithashtu edhe për hartimin e planit të masave që duhen marrë në universiteti dhe njësie kryesore. Procedurat e sigurimit të cilësisë vlerësohen periodikisht dhe të gjitha rezultatet e performancës me propozimet përkatëse i paraqiten Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Standardeve të Cilësisë së Institucionit dhe Senatit. Vlerësimet programore e të departamenteve planifikohen për</p>

	çdo vit akademik bazuar në rezultatet e proceseve të kryer. (E.16, Evidenca shitesë A.4.1, E.14).			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në tërësi, por edhe sanksionuar nga neni 5 i rregullores për sigurimin e cilësisë, nëpërmjet procesit vlerësues synohet: kontrolli i cilësisë, vlerësimi i gjendjes së cilësisë dhe propozime për përmirësimin e saj UT, në aktet e brendshme parashikon procedura të hollësishme lidhur me përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit, hapat përkatëse dhe njësitë e strukturat që do marrin vendime në bazë të të dhënave të administruara nga procesi i vlerësimit të cilësisë Rregullimet specifike mbi mënyrën e administrimit të të dhënave tregon rëndësinë që universiteti i kushton këtij procesi. (Ref. E.6, E.16)			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	GVJ vëren se institucioni ka organizuar veprimtari në relativisht periodike me personelin dhe me studentët me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin për sigurimin e përmirësimin e cilësisë së programit të studimit Specifikisht, sipas RVB, në 2021 janë organizuar 6 trajnime/seanca me GVB-të e njësisive të UT-së, me pjesëmarrjen e ekspertëve të fushës për informimin e tyre në lidhje me procesin e vlerësimit dhe akreditimit të programeve të studimit (Evidenca shitesë B.6).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkenvave në “Politika dhe Qeverisja në Evropë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit ka një rritje të numrit të pedagogëve në tre vitet e fundit duke krijuar bazat për një cilësi më të lartë akademike si në mësimdhënie ashtu edhe në kerkimin shkencor.
2. Ndërkombëtarizimi i programit të studimit, sidomos nëpërmjet programeve Jean Monnet të BE-së, i mundëson personelit akademik dhe studentëve të përfitojnë nga shkëmbimi dhe bashkëveprimi me kërkues shkencor nga BE-ja, përfshirë këtu pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca tematike.
3. Programi po përfundon sistemin anti-plagjaturë, i cili mendohet të jetë gati së shpejti për të ndihmuar studentët dhe pedagogët në këtë proces.
4. Nga fillimi i vitit një sistem LMS është në funksion të plotë dhe shërben si për dhënien e informacioneve ashtu edhe për mbajtjen e tyre nga sekretaria mësimore.
5. Programi ka mekanizma të përshtatshëm dhe fleksibël për monitorimin dhe vlerësimin e aftësisë mësimdhënëse të personelit akademik.
6. Megjithëse aktualisht vërehet një numër i ulët i pjesëmarrjes së studentëve në punimet shkencore, trupa mësimore po i kushton një rëndësi integritit në rritje të studentëve në projektet shkencore sidomos nëpërmjet aktiviteteve të organizuara në kuadër të programit Jean Monnet.

Pika të dobëta

1. Numri i studentëve që ndjekin studimet për një semestër në IAL është i vogël dhe mungon një azhurnim i studimit të tregut, i cili të përfshijë në mënyrë periodike të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës. (*Standardi I.3*)
2. Njësia bazë - pavarësisht se është pjesë e një njësie kryesore **ndërfakultetore** organizimi i ndryshëm i të cilës është sanksionuar në statutin e UT – duhet të përmbushë kriterin e numrit të nevojshëm të PAE, për të patur një harmonizim më të mirë të ngarkesës në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. (*Standardi II.2*)
3. Disa sylabuse kanë materiale bazë të cilat nuk janë në nivelin e duhur të përditësimit ndërsa ka lëndë, të cilat janë mjaft të përgjithshme dhe nuk ofrojnë prizmin e trajtimit të tematikave në përputhje me karakteristikat apo fokusin e programit.
4. Nuk është i plotë dhe koherent përditësimi i faqes së ISE me informacioni si përsa i takon aktiviteteve/programit ashtu edhe personelit akademik. (*Standardi VI.5*)





Rekomandime

1. ISE duhet të përmbushë sa më mirë kriterin e numrit të nevojshëm të PAE, për të patur një harmonizim më të mirë të ngarkesës së në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.
2. Një azhornim i të dhënave mbi tregun e punës për të kuptuar më mirë nevojat e tij për të kuptuar nevojat e tregut dhe përmirësimin e kurrikulave për t'iu përgjigjur këtyre nevojave.
3. Përmirësimi i disa lëndëve me karakter të përgjithshëm dhe përditësimi i tyre duke patur parasysh evolimin e shpejtë të tematikave që kanë të bëjnë me BE dhe integrimin evropian.
4. Të zhvillohet një analizë mbi efektet dhe pritshmëritë për aplikimin e metodave të reja në mësimdhënie dhe të zgjerohen mundësitë e trajnimit të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.
5. Sugjerohet fillimi i një projekti hulumtues në fushën e studimeve të Integritit dhe Qeverisjes evropiane që mund të kontribuojë në përfshirjen e studentëve në punime shkencore.
6. Këshillohet përfshirja e studentëve dhe strukturave të tyre në funksion të përmirësimit të programit të studimit.
7. Rekomandohet emerimi i një ekspert të jashtëm në KSBC.
8. Një azhornim sa më i mirë i faqes së internetit të programit.

Conclusions of the Evaluation of the second cycle study program Master of Science in "Politics and Governance in Europe" of the Institution of Higher Education "University of Tirana"

Strengths and affirmations

1. The number of staff has gradually increased in the last three years, creating opportunities for further improving the quality of teaching and research.
2. The academic staff of this programme, as part of the ISE, are participating since the first semester of this year, in three Jean Monet projects dedicated to the qualification of the academic staff.
3. The programme is completing the anti-plagiarism system, which will be soon in place to help the academic staff in this process.
4. The LMS system is fully functional from the beginning of this year to help students to receive the necessary information and the teaching secretary in keeping track of data and information.
5. The program has suitable and flexible monitoring and evaluation mechanisms regarding teaching quality.
6. Although at the moment, the number of students participating in the research projects is not satisfactory, the teaching team is focused on increasing the number of students





in research projects, thanks also to the activities organized in the framework of the Jean Monnet programme.

Weaknesses

1. The number of students pursuing studies for one semester in the programme is small and there is a lack of update of the market study, which would periodically include data provided by official communication with employers in the field, their requirements and needs, opportunities and student employment, data on real student employment and expected developments in the relevant sector.
2. The basic unit - despite being part of a main interfaculty unit whose different organization is sanctioned in the UT statute - must fulfill the criterion of the necessary number of PAE.
3. Some syllabuses offer in the mandatory materials articles and materials, which are not fully up-to-date, which is key to programmes related to the European integration. Some subjects offer a general overview, which could be good-enough for any social-science programme, but there are not tailored to the focus of the programme topics.
4. The process of updating the ISE website concerning information about the academic programme and activities as well as the teaching team profiles and publications is not conducted on regular basis.

Recommendations

1. A coherent update of the labour market data, in order to effectively analyze its needs and reflect it in the process of curricula improvement.
2. Improving the syllabuses of the subjects keeping in mind the quick updating of topics and aspects related to the European Union and the European integration.
3. ISE needs to adequately comply concerning the criteria on the number of PAE necessary for the programme, so to be able to harmonize better the balance of teachers workload between teaching and research activities.
4. To conduct an analysis on the effects and expectations for the application of new methods in teaching and to expand the training opportunities of academic staff to improve teaching skills and implement new methods.
5. It is suggested to start a research project in the field of European Integration and Governance studies that can contribute to the involvement of students in scientific papers.
6. We recommend to appoint an external expert as a permanent member of the KSBC.
7. A more complete and coherent update of the programme website.
8. It is advisable to further involve students and their structures in order to improve the study program.



SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT			X	
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X